REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTRI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE

"AXHENDA DIXHITALE E SHQIPËRISË 2014-2020"

PËRMBAJTJA

1 SITUATA AKTUALE NË SHQIPËRI 11
1.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM 12
1.2 SITUATA EKZISTUESE SIPAS FUSHAVE 14
1.2.1 KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE E KOMUNIKIMIT 14
1.2.2 SHOQËRIA E INFORMACIONIT 23
1.2.3 KËRKIMI SHKENCOR DHE INOVACIONI 31
1.2.4 PLANI KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E BROADBAND 32
1.2.5 STRATEGJIA PËR KALIMIN NGA TRANSMETIMI ANALOG NË ATË DIXHITAL 33
1.2.6 CERTIFIKIMI ELEKTRONIK 34
1.2.7 TEKNOLOGJITË E INFORMIMIT E TË KOMUNIKIMIT NË ARSIM 35
1.2.8 QEVERISJE E HAPUR NËPËRMJET PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJISË 37
1.2.9 INFRASTRUKTURA PËR INFORMACIONIN GJEOHAPSINOR 38
1.2.10 SITUATA NË FUSHËN E TIK-UT NË SEKTORIN SHËNDETËSOR 39
1.2.11 Sistemi i Punësimit 41
1.2.12 DREJTËSIA (TIK) 42
1.2.13 PËRGATITJA E QEVERISË VENDORE PËR E–QEVERISJE 43
2 VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET E POLITIKAVE 45
2.1 VIZIONI 45
2.2 Qëllimi i Strategjisë 45
2.3 DREJTIMET KRYESORE 46
3 OBJEKTIVAT E STRATEGJISË 47
4 PROGRAMI I INVESTIMEVE NË FUSHËN E TEKNOLOGJIVE TË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT 52
5 PLANI I VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E STRATEGJISË AXHENDA DIXHITALE E SHQIPËRISË 2014-2020 56
5.1 PRESPEKTIVA E E-GOVERNMENT 2014-2020 56
5.1.1 Lidhja e sistemeve IT me ESB- realizimi i plotë i ndërveprimit 58
5.1.2 Një shoqëri informacioni e sigurtë 58
5.2 Inovacioni dhe Zhvillimi i Teknologjisë për SME-të. 59

DRAFT

5.2.1 Nxitja e konkurrueshmërisë së SME-ve dhe inovacioni 60
5.2.2 Rritja e aftësisë së bizneseve shqiptare për të zhvilluar, përdorur, përshtatur dhe komercializuar teknologjinë 60
5.3 KËRKIMI SHKENCOR DHE INOVACIONI 63
5.3.1 Përmirësimi i cilësisë së kërkimit shkencor në sektorin publik 63
5.3.2 Mbështetja sistematike për inovacionin dhe transferimin e teknologjisë në sektorin prodhues 64
5.3.3 Përmirësimi i kapaciteteve institucionale të sistemit të kërkimit dhe inovacionit 64
5.4 e-ARSIMI 65
5.5 INFRASTRUKTURA KOMBËTARE E INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR 66
5.6 e-MJEDISI 68
5.7 e-SHËNDETËSIA 70
5.7.1 Ngritja e "Sistemi i checkup-it për grup moshën 40-65 vjeç" 70
5.7.2 Sistemi i mbledhjes dhe raportimit të të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, publik ose privat. 70
5.7.3 Sistemi i regjistrimit dhe kontrollit të barnave 70
5.7.4 Sistemi i gjurmimit të barnave mjekësore (Track and Trace) 71
5.7.5 Receta Elektronike (e-Prescription) 71
5.7.6 Sistemi informatik për menaxhimin e spitaleve (Hospital Information System) 72
5.7.7 Sistemi i Regjistrimit të Imunizimit dhe Inventarit të Vaksinave 72
5.7.8 Sistemi kombëtar Portal për Pacientët dhe i shërbimeve elektronike për qytetarët 73
5.7.9 Sistemi i monitorimit të indikatorëve të performancës së sistemit shëndetësor 73
5.7.10 Sistemi i menaxhimit të stafit dhe aseteve mjekësore 73
5.7.11 Projekti "eHealth – Rekordi Elektronik Shëndetësor Kombëtar" 74
5.8 SIGURIA KOMPJUTERIKE 74
5.9 QEVERISJE E HAPUR NËPËRMJET PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJISË 75
5.10 QEVERISJA ELEKTRONIKE VENDORE (E-QV) 75
5.10.1 e-Pjesëmarrja dhe qeverisja e hapur vendore 76
5.10.2 Sistemet e interoperabilitetit QQ-QV 77
5.10.3 Z1N (Zyra elektronike me 1 Ndalesë) 77
5.11 Internet Broadband për Zonat Malore 78
5.12 I-Learn/ Unë mësoj 78

DRAFT

5.13 Inovacioni kundër korrupsionit 79
6 ANALIZA SWOT (STRENGTH, WEAKNESS, OPPORTUNITIES, THREATS) 81
7 LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE 83

DRAFT

LISTA E AKRONIMEVE

MZHUT- Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit

MZHETS- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

MAS- Ministria e Arsimit dhe Sportit

MMSR – Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

MSH- Ministria e Shëndetësisë

MIAP- Ministria Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike

AKSHI Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit

INSTAT- Institutit i Statistikës

KMDHP-Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

AMA- Autoritetit i Mediave Audiovizive

AKEP- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

AKTI- Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit

QKL-Qendra Kombëtare e Licensimit

QKR- Qendra Kombëtare e Rregjistrimit

ASHZHI-Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

DAP-Departamenti i Administratës Publike

AKCE- Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik

ASHDHGJH-Autoritetit Shtetëror për të Dhënat Gjeo Hapësinore

APP-Agjencia e Prokurimit Publik

DPZHFNH- Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj

FSHU- Financimi i Shërbimit Universal

OSHC-Ofrues i Shërbimit të Certifikimit

SMIP-Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar

DBAL- Baza Elektronike e të dhënave të arsimit të lartë

GIS -Geographical Information System

GI- Informacionin Gjeografik

DRAFT

NSDI- Infrastruktura Kombetare e të Dhënave Hapsinore

SISP - Sistemi i Informacionit për shëndetin Publik

QSUT- Qendra Spitalor Universitare Tirane

BB-Banka Botërore

BE-Bashkimi Europian

bSEE-Broadband South Eastern Europe

E Government-Qeverisja elektronike

e-Services-Sherbime elektronike

e- Biznesi -Biznesi elektronik

eSEE-Europa Juglindore elektronike (Electronic South Eastern Europe)

EUROSTAT Statistical Office of the European Communities (Zyra e Statistikave e Komunitetit Europian)

GovNet Government Network (Rrjeti qeveritar)

ISP Internet Service provider (Ofruesi i sherbimit Internet)

ITU International Telecommunications Union (Bashkimi Nderkombetar i Telekomunikacioneve)

KE Komisioni Evropian

KM Këshilli i Ministrave

OECD Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

PKI Public key infrastrukture

SEMD Sistemi elektronik per kontrollin e gjendjes gjyqesore

SKZHI Strategjia e Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

TIK Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (Information and Communication Technology)

3G Gjenerata e trete e rrjeteve te telefonise se levizshme

VoIP Telefonia ne internet (Voice over IP)

UN Kombet e Bashkuara

UNDP- Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (United Nations Development Program)

DRAFT

xDSL-Teknologji qe ofrojne transmetimin e te dhenave dixhitale

MSA- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

IDI – Indeksi i zhvillimit të TIK

IPB- Indeksi i shportës së çmimeve në TIK

NRI- indeksi i gadishmërisë së rrjetit

e-Z1N Zyra elektronike me 1 Ndalesë

DSHU- Direktiva e Shërbimit Universal

DRAFT

HYRJE

Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe Interneti luajnë një rol të veçantë në zhvillimin e një ekonomie konkuruese të bazuar në njohuri dhe inovacion. Kjo teknologji mundëson sigurimin e një cilësie më të lartë të jetës për qytetarët, ndihmon në proceset e biznesit si dhe rritje të efektivitetit dhe transformimin e qeverisjes. Zhvillimi i sektorit TIK është përcaktuar si një politikë horizontale pasi efektet dhe ndikimet e zbatimit të tij shtrihen mbi të gjithë sektorët e tjerë social-ekonomike të një vendi.

Teknologjitë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) konsiderohen si një seri të teknologjive për mbledhjen, ruajtjen, gjetjen, përpunimin, analizimin, dhe transmetimin e informacionit. Zhvillimet dinamike të tregut dhe teknologjive kanë çuar në një konvergjencë ku kufijtë midis shërbimve të veçanta TIK, rrjeteve dhe praktikave të biznesit nuk ekzistojnë më.

Prioritetet e TIK në nivel europian janë të përshkruara në Europa 2020 - një strategji për rritje të qëndrueshme dhe gjithë përfshirëse që synon përgatitjen e ekonomisë së BE për sfidat e dekadës së ardhshme. Qëllimi i saj në mënyrë të veçantë është për të përmbushur një nga nismat e saj - të njohur si Axhenda Dixhitale për Evropën (DAE)[1], e cila është e lidhur drejtpërdrejtë me problemet në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Internetit.

Në analogji me politikat dhe prioritetet e Bashkimit Europian, zhvillimi i TIK dhe axhenda dixhitale zënë vend në programin e qeverisë shqiptare. Programi i qeverisë për 2013-2017, parashikon si prioritet zhvillimin e shoqërisë së informacionit, teknologjinë e informimit dhe te komunikimit (TIK). Programi e shikon zhvillimin e TIK dhe e-shërbimet të lidhura ngushtë me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Në programin e qeverisë është përcaktuar se qeveria do të punojë në 3 drejtime kryesore duke vendosur objektiva të matshme:

- **Së pari**, për shtimin dhe promovimin e shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike sipas parimeve të iniciativës Open Government Partnership.
- **Së dyti**, për përdorimin e TIK në edukim për të kapërcyer hendekun dixhital dhe për të aftësuar rininë. Politikat do të jenë të orientuara drejt përmirësimit dhe

[1] *Një Axhendë Dixhitale për Evropën, COM(2010)245, miratuar 19 .05. 2010, EC*

zgjerimit të kapaciteteve njerëzore në mënyrë që të rritet numri i përdoruesve dhe të promovohet zhvillimi i ofruesve të e-shërbimeve. Në këtë mënyrë do të nxitet krijimi i vendeve të punës në këtë fushë për tregun shqiptar, rajonal e më gjerë.

- **Së treti**, konsolidimi i infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar me rigorozitet parimet evropiane të konkurrencës së lirë e të ndershme.

TIK është pranuar gjerësisht si një nga forcat kryesore lëvizëse të ekonomisë, duke krijuar inovacion dhe dhënë formë shoqërisë së informacionit. Një e katërta e rritjes së PBB-së në BE është krijuar në sektorin e TIK. Synimi ne BE është që investimet dhe inovacionet në TIK të kontribuojë në rritjen e produktivitetit në BE me 45%. Në Shqipëri, sektori TIK dhe ne vecanti tregu i komunikimeve elektronike jep një kontribut në GDP që llogaritet në 5-6%.

TIK dhe proceset e dixhitalizimit bashkarisht mbeshtesin proceset inovatore si:

- **Proceset ekonomike:** permes zhvillimit te kapaciteteve prodhuese të bazuara në TIK, të ekonomisë së dijes dhe start-ups, krijimin e smartcities & komuniteteve, bujqësinë strategjike, ndërmarrjen sociale, etj;
- **Proceset sociale:** ne mbështetjen për shërbimet ndaj komunitetit dhe prodhimit të të mirave të përbashkëta, inovacionit social, crowdsourcing e crowdfounding, etj;
- **Proceset institucionale dhe administrative:** permes shërbimeve e-Government, identitetit dixhital, kuadrit të interoperabilitetit, thjeshtëzimit të procedurave institucionale dhe administrative, shërbimeve ndihmëse, pjesemarrjes ne vendimmarrje te qytetareve dhe biznesit etj.

Në mënyrë të përmbledhur TIK do të konsiderohen në dy drejtime:

a) TIK si një faktor nxitës apo si teknologji që po ndryshon jetën tonë të përditshme, transformon organizimin e punës, ndryshon tregjet ekzistuese dhe krijon mundësi dhe modele të reja biznesi, qe krijon mundesi të reja per pjesëmarrjen, bashkëpunimin e ndërveprimin me Administratën Publike, nje qeverisje te hapur, dhe transparente.

Në këtë kendveshtrim duhet rishikuar procesi i dixhitalizimit në një mënyrë më sistematike në çdo fushë të jetës duke filluar nga: shkolla, turizmi&kultura, drejtësia, transporti etj.

DRAFT

b) TIK si politikë sektoriale e lidhur me mbështetjen ndaj ndërmarrjeve TIK, kërkimit & inovacionit (TIK si KET - key enabling technologies).

Në këtë drejtim duhet vëmendje e vecantë për ndërhyrjet/nismat që duhen ndermarre për të pasur infrastrukturën e përshtatshme si rrjetet me brez të gjerë ashtu dhe data center, për të garantuar nivele sigurie të larta të rrjeteve të informimit, për të integruar dhe informatizuar shërbimet e Administratës Publike po jo vetem.

Objektivi kryesor i Axhendës Dixhitale për Evropën është krijimi i përfitimeve të qëndrueshme ekonomike dhe sociale nga krijimi i nje tregu të vetëm dixhital të bazuar në përdorimin e internetit të shpejtë dhe ultra të shpejtë, si dhe te aplikacioneve të ndërveprueshme. Ne keto procese BE synon t'i hapë rrugë maksimizimit te potencialit social dhe ekonomik. Agjenda dixhitale për Evropën ka identifikuar shtatë dimensione, shtylla prioritare të ndërlidhura:

1. Një treg të vetëm dixhital;
2. Standarde dhe ndërveprim;
3. Besim dhe Siguri;
4. Akses në Internet të Shpejt dhe Ultra të Shpejt;
5. Kërkim dhe Inovacion;
6. Përmirësim të Arsimit, Aftësive dhe Përfshirjes Dixhitale;
7. Përfitime nga TIK për gjithë Shoqërinë e BE;

Zhvillimet per TIK dhe shoqërinë e informacionit në Shqipëri kanë qenë të bazuara ne modelin Europian e pare kjo ne harmoni me zhvillimet rajonale dhe në perspektivën e integrimit me Bashkimin Europian. Në nëntor të vitit 2013 vendet e Europes Juglindore miratuan Strategjinë Rajonale per Europen Juglindore, SEE-2020. Në këtë dokument strategjik objektivat për zhvillimin e axhendës dixhitale zënë vend nën dimensionin e Shoqërisë Dixhitale të shtylles "Për një rritje të zgjuar", Smart growth.

DRAFT

Ky dokument që prezanton axhendën dixhitale për 2014-2020 vjen në harmoni me objektivat e zhvillimeve rajonale dhe me ato te BE-se duke u pershtatur me kushtet dhe zhvillimet konkrete te vendit.

Dokumenti pas nje analize të situates dhe zhvillimeve aktuale, përcakton vizionin dhe objektivat e zhvillimit për periudhën 2014-2020 si dhe jep drejtimet kryesore të politikave që do të ndiqen për realizimin e këtyre objektivave.

1 SITUATA AKTUALE NË SHQIPËRI

Sektori TIK është sektor i rëndësisë së veçantë me impakt të madh në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Liberalizimi i tregut të komunikimeve elektronike, zgjerimi i përdorimit të internetit në gjithë vendin dhe shtrirja e shërbimeve elektronike në funksionet e qeverisë (G2G) si dhe fillimi i ofrimit të shërbimeve elektronike G2C dhe G2B janë disa arritje të rëndësishme në kuadër të zhvillimit të Shoqërisë së Informacionit.

Gjatë periudhës 2008-2013, një sërë ligjesh janë hartuar në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian . Aktualisht shërbimet elektronike Qeveri – Qytetar mbeten kryesisht në nivele informuese që përbëjnë nivelet e para të zhvillimit të e-Qeverisjes.

Gjatë periudhës 2008-2013 ka pasur një progres në shërbimet publike Qeveri – Biznes duke përmendur këtu ngritjen e Qendrës Kombëtare të Liçensimit, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, zgjerimin e infrastrukturës GovNET, shërbimet e-taksa, e-prokurimi, e-dogana, e-patenta etj. Këto zhvillime kanë ndikuar në përmirësimin e indeksit të gadishmërisë për qeverisjen elektronike. Indeksi i Qeverisjes Elektronike për Shqipërinë është 0.5046 (vendi i 84-të nga 190 vende), kundrejt 0.467 në vitin 2008 (vendi i 85-të nga 182 vende). Ndërsa, indeksi për ofrimin e shërbimeve online për Shqipërinë është rritur nga 0.3913 në vitin 2008, në 0.4488 në vitin 2014 . Por situata e Shqipërisë krahasuar me vendet e rajonit sipas raporteve të UNPAN , mbetet në nivele të ulta në renditjen rajonal si: Greqia vendi i 34; Kroacia vendi i 47, Bullgaria vendi i 73, Serbia vendi i 69, etj dhe në nivel mesatar në renditjen botërore.

Qeveria vendore (QV) në Shqipëri po zhvillon sjelljen e saj ndaj shoqërisë së informacionit dhe TIK, por qeverisja tradicionale (t–Qev) vijon të jetë dominuese dhe disa hapa prapa nga e–Qeverisja në nivel qendror.

DRAFT

Politikat dhe objektivat kombëtare në kuadër të Strategjisë për Shoqërinë e Informacionit kanë qenë modeste për qeverisjen vendore, ndërkohë që ka vënde të cilat kanë aplikuar strategji të veçanta për e–Qeveri vendore.

Kjo ka bërë që ky nivel të mos jetë i përfshirë specifikisht në raportet kombëtare për e–Qeverinë dhe qeverinë e hapur, sikundër përpjekjet për matjen e performancës të jenë të fragmentuara dhe mbështetura kryesisht nga burimet e donatorëve.

1.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit 2008-2013 (SNSHI) e miratuar me VKM Nr. 59 dt. 21.1.2009 përbën dokumentin strategjik që përcaktonte drejtimet kryesore dhe objektivat e zhvillimit në fushën e shoqërisë së informacionit gjatë 2008-2013. Ky dokument pasonte dokumentin e parë të strategjisë për TIK të miratuar në vitin 2003 dhe vinte në plotësim të objektivave kryesore për TIK të përcaktuar në dokumentin e SKZHI-së 2007-2013.

Bazuar në situatën e zhvillimit të TIK dhe shoqërisë së informacionit në vitin 2008, ku idenfikohej një penetrim tepër i ulët i internetit, penetrim tepër i ulët PC në familje, telefonisë fikse, penetrimi i telefonisë celulare në 70%, disa zhvillime të shërbimeve elektronike kryesisht të lidhura me biznesin, një kuadër institucional dhe ligjor jo i plotësuar për shoqërinë e informacionit, SNSHI ishte e ndërtuar në pesë komponente kryesorë:



Zhvillimi i kuadrit ligjor dhe institucional
Zhvillim i infrastrukturës TIK mundësimi i një interneti të lirë dhe të shpejtë
Zhvillimi i e-qeverisjes
Edukimi dhe njohuritë për TIK
Promovimi i e-biznesit

Objektivat kryesore të kësaj strategjie për e-qeverisjen dhe shoqërinë e informacionit ishin:

- ✓ Zhvillimi i Qeverisjes Elektronike;
- ✓ Krijimi i kushteve për përhapjen e TIK në administratën publike dhe ofrimin e shërbimeve online për qytetarët;
- ✓ Modernizimin e administratës publike;
- ✓ Ndërtimin e një shoqërie informacioni, që çon në rritjen ekonomike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës;
- ✓ Zhvillimin e një modeli për qeverisjen elektronike, duke marrë parasysh çështjet specifike të sektorit publik në tërësi.

Përpjekjet e institucioneve shqiptare janë fokusuar në zhvillimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe institucional në mënyrë që të sigurohet mjedisi efikas për komunikimin e biznesit, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturave të përparuara të komunikimit elektronik për nevojat e administratës publike dhe qeverisjes elektronike, rregullimet ligjore për menaxhim të spektrit mbi bazën e teknologji neutral për të promovuar zhvillimin e infrastrukturës broadband, zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve elektronike për bizneset dhe individët në kuadër të qeverisjes elektronike, duke ofruar shkallë të lartë ndërveprimi, sigurisë së rrjeteve dhe informacionit.

Pavarësisht progresit te deritanishëm në fushën e TIK, situata e pare në shtrirjen e TIK ne gjithë vendin nuk është në nivele të kënaqshme. Shqipëria ende mbetet larg nivelit mesatar jo vetëm të vendeve të BE por edhe atyre të rajonit lidhur me aksesin ne infrastrukturat dhe shërbimet broadband.

Disa nga Projektet dhe Iniciativat në Fushën e Shoqërisë së Informacionit në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale 2008-2013***:*** :

1. Hartimi i dokumentit për internet te shpejtë; (Plani Kombëtar i Broadbandit)
2. Harmonizimi i përdorimit të spektrit në Shqipëri në përputhje me Legjislacionin e BE-së dhe rekomandimet e ITU;
3. Qeverisja Elektronike;
4. Përmirësimi i cilësisë në e-Learning (arsimi dixhital);
5. Sigurimi i Internetit super të shpejtë për përdoruesit e rrjetit GovNET

DRAFT

6. Implementimi dhe zgjerimi i GovNET, rritja e numrit të institucioneve të lidhura në GovNET;
7. Krijimi dhe përmirësimi i portalit e-Albania
8. Krijimi i Autoritetit Shtetëror për të Dhënat Gjeo-Hapësinore;
9. Siguria e fëmijëve online;
10. Zhvillimi implementimi i sistemit te e-akteve
11. Zhvillimi i telemedicinës;
12. Krijimi i Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik;
13. Krijimi i Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT);
14. Krijimi i Këshillit Kombëtar të CIO-ve;
15. Krijimi i Autoritetit Shtetëror për të Dhënat Gjeo Hapësinore
16. Siguria e fëmijëve online, nxitja dhe koordinimi i procesit per kodet e sjelljes
17. Pjesëmarrja në Partneritetin për Qeverisje të Hapur (OGP);
18. Krijimi i datacenter qeveritar;
19. Krijimi i infrastrukturës për ndërveprimin e sistemeve, ESB;
20. Krijimi i infrastrukturës për PKI dhe ofrimi i shërbimeve të sigurta;
21. Zhvillimi i infrastrukturës "Cloud computing";
22. Hartimi dhe miratimi i ligjit për tregtinë elektronike, ligjit për bazat e të dhënave shtetërore, ligjit për dokumentin elektronik, ndryshimet në kodin penal për krimin kibernetik, ndryshimi i ligjit për komunikikmet elektronike, një sërë aktesh nënligjore për aspekte të ndryshme të e-qeverisjes
23. etj.

1.2 SITUATA EKZISTUESE SIPAS FUSHAVE

1.2.1 KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE E KOMUNIKIMIT

Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm lidhur me përafrimin e legjislacionit në fushën e komunikimeve elektronike me rregullat e Bashkimit Evropian.

DRAFT

Ligji Nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin Nr. 102/2012 është në përputhje me acquis communautaire më të fundit të BE-së. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, në nenin 104 të saj: "Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik" përcakton se:

Palët bashkëpunojnë gjithashtu për të zhvilluar më tej Shoqërinë e Informacionit në Shqipëri. Objektivat globale do të përgatisin shoqërinë në tërësi për epokën dixhitale, duke tërhequr investimet dhe duke siguruar aftësinë e rrjeteve dhe shërbimeve për përdorimin e informacionit.

Regjimi i autorizimit të përgjithshëm për të gjitha rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike u prezantua në vitin 2008. Plani i ri Kombëtar i Frekuencave me qëllim zbatimin e parimit teknologji neutral dhe përdorimin e shërbimeve të mundësuara nga 3G dhe 4G në brezat e frekuencave 900 MHz dhe 1800 MHz u miratua në fillim të vitit 2013.

Në tregun e komunikimeve elektronike operojnë sot katër operatorë të telefonisë celulare. Aktualisht ka rreth 79 operatorë alternativë të telefonisë fikse dhe 131 ofrues të shërbimit internet, ISP. Ka tre operatorë që ofrojnë shërbime të lëvizshme me brez te gjerë bazuar në 3G, penetrimi i broadbandit dhe veçanërisht rritja në segmentin mobile broadband në nivel 37%, në fund të vitit 2013, bazuar në të gjitha tipet e pajisjeve përfshirë smartphone dhe tablete. Gjatë viteve të fundit, procesi i përafrimit të kuadrit rregullator kombëtar në fushën e komunikimeve elektronike ka ecur me hapa të shpejtë. Konkurrenca në tregun e komunikimeve elektronike është rritur si rezultat i politikave të ndërmarra nga qeveria dhe masat rregullatore të zbatuara përmes rregullimit të tarifave të terminimit, implementimit të portimit të numrit në telefoninë e lëvizshme dhe fikse, etj.

1.2.1.1 Panorama e tregut

Gjatë vitit 2013 sektori i komunikimeve elektronike ka pasur rritje të përdorimit të shërbimeve të rrjeteve celulare dhe aksesit broadband Internet, ndërsa ka pasur ulje të segmentit të telefonisë fikse. Këto tendenca janë të ngjashme me tendencat e viteve të fundit, ku përdorimi i telefonisë fikse ka qënë në rënie duke u zëvendësuar me telefoninë celulare, dhe aksesi broadband ka pasur rritje në të dy segmentet: nga rrjete fikse dhe rrjete celulare.

DRAFT

Numri i përdoruesve celularë aktive (pajtimtarë që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit) në fund të vitit 2013 arriti ne 3.7 milion, krahasuar me 3.5 milion në fund të vitit 2012. Kjo përbën një rritje vjetore me 4% për të katër operatorët, ndërkohë që numri i perdoruesve të telefonisë së lëvizshme sipas kartave SIM aktive, pati reduktim me 6%, duke arritur në 5.3 milion krahasuar me 5.6 milion në fund të vitit 2012. Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në 2013 ishte 130% sipas përdoruesve aktivë dhe 187% sipas kartave SIM.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2013, arriti në rreth 281 mijë, krahasuar me rreth 311 mijë që ishte në fund të vitit 2012, pra një rënie me 10%. Rënia e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse është në vijim të tendencës rënëse të nisur në 2010, me përjashtim të vitit 2011 që pati rritje. Rënia ka ardhur për shkak të vazhdimit të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me 9% si dhe rënies me 13% të numrit të pajtimtarëve të operatorëve alternativë. Norma e penetrimit të telefonisë fikse në fund të vitit 2013 ishte rreth 10%.

Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks dhe celular (3G me karta USB/modem) në fund të vitit 2013 arriti në rreth 294 mije, që përbën një rritje me 36% në krahasim me vitin 2012. Në 2013 të dy segmentet e aksesit broadband, fiks dhe 3G (me karta USB/modem), kanë pasur rritje me 14% dhe 101% respektivisht. Norma e penetrimit me të dy llojet e aksesit së bashku është 10.4% për popullsi dhe 37% për familje.

Më poshtë jepet ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonise celulare (përdorues aktivë) dhe telefonisë fikse në raport me aksesin broadband me rrjete celulare dhe fikse. Figurat tregojnë qartë se normat e rritjes së aksesit broadband në të dy llojet e rrjeteve janë më të larta se të telefonisë. Për rrjetet fikse ka madje tendenca të kundërta: rritje e aksesit broadband dhe rënie e telefonisë fikse. Në 2013 33% e përdoruesve aktive celularë përdorin akses broadband 3G, dhe numri i pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse përbën 65% të pajtimtarëve të telefonisë fikse.

1.2.1.1.1 TELEFONIA CELULARE

<u>Numri i përdoruesve celularë</u>

Numri i përdoruesve celularë aktivë në fund të vitit 2013 arriti në 3.7 milion, krahasuar me 3.5 milionë në fund të vitit 2012. Kjo përbën një rritje vjetore me 4% për të katër operatorët, ndërkohë që norma e rritjes ndryshon sipas operatorëve: Plus dhe Vodafone kanë rritje me 9 dhe11% respektivisht, ndërsa Albtelecom (EM) dhe AMC kanë reduktim 2 dhe 3%

respektivisht. Figura 2, paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë aktivë në periudhën 2010-2013.



	2010	2011	2012	2013
Plus	28,162	182,391	202,426	221,086
EM	602,775	415,307	435,922	424,237
Vodafone	1,129,715	1,358,871	1,491,126	1,659,697
AMC	1,396,752	1,151,518	1,407,811	1,380,963

Figura 1: Ecuria e numrit të përdoruesve celularë aktive 2010-2013



Figure 2: Ecuria e numrit të përdoruesve celularë sipas kartave dhe SIM 2000-2013

1.2.1.1.2 TELEFONIA FIKSE

Telefonia fikse edhe gjatë vitit 2013 ka vazhduar tendencën rënëse të viteve të fundit, e cila megjithëse është në linjë me tendencën rënëse në vendet e BE, norma e penetrimit prej 10% është shumë më ulët se në vendet e BE. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të

vitit 2013, arriti në rreth 281 mijë, krahasuar me rreth 311 mijë që ishte në fund të vitit 2012, pra një rënie një renie me 10%. Rënia ka ardhur për shkak të vazhdimit të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me 9% si dhe rënies me 13% të numrit të pajtimtarëve të operatorëve alternativë.

Figura e mëposhtëme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse dhe Albtelecom dhe operatorëve alternativë në periudhën 2000-2013.



	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Albtelecom	152,7	197,5	213,0	228,8	236,2	248,0	259,6	261,1	263,9	292,8	277,7	258,9	230,3	210,3
OA			9,000	15,00	20,00	25,00	30,00	35,00	40,00	45,00	53,73	79,90	81,26	70,81
Total Fiks	152,7	197,5	222,0	243,8	256,2	273,0	289,6	296,1	303,9	337,8	331,5	338,8	311,6	281,2

Figure 3:Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2013

Tabela e mëposhtëme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse të operatorëve kryesorë në periudhën 2010-2013.

	Albtelecom	Abcom	ASC	Nisatel	AMC Fiks	OA te tjere	Total Fiks
2010	277,763	19,975	7,408	5,900	-	20,456	331,502
2011	258,943	27,167	10,129	4,950	7,565	30,090	338,844
2012	230,397	33,000	7,649	5,500	6,119	28,996	311,661
2013	210,382	13,680	15,047	7,166	6,950	27,975	281,200
Ndryshimi 2013/2012	-9%	-59%	97%	30%	14%	-4%	-10%

Tabela 1: Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse për periudhën 2010-2013



Figura e mëposhtme paraqet pjesët e tregut të operatorëve kryesorë të telefonisë fikse, ku vihet re që Albtelekom vazhdon të ketë 75% pjesë tregu, pasi rënia e numrit të pajtimtarëve ka qenë tendencë e të gjithë tregut.

Figure 4: Pjesët e tregut të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2013

1.2.1.1.3 INTERNETI

Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks dhe celular (3G me karta USB/modem) në fund të vitit 2013 arriti në rreth 294 mijë, që përbën një rritje me 36% në krahasim me vitin 2012.

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e pajtimtarëve broadband fiks dhe 3G, dhe numrin e pajtimtarëve si përqindje e popullsisë dhe numrit të familjeve (penetrimi). Në 2013 të dy segmentet e aksesit broadband fiks dhe 3G (me karta USB/modem) kanë pasur rritje me 14% dhe 101% respektivisht. Norma e penetrimit për të dy llojet e aksesit së bashku është 10.4% për popullsi dhe 37% për familje.

	Numri i pajtimtarëve			**Penetrimi**				
				Popullsi			**Famile**	
	Total Fiks	**Total 3G**	**Total Fiks + 3G**	**Fiks**	**3G**	**Fiks +3G**	**Fiks**	**Fiks +3G**
2011	139,697	34,493	174,190	4.9%	1.2%	6.2%	17%	22%
2012	160,088	55,405	215,493	5.7%	2.0%	7.6%	20%	27%
2013	182,556	111,367	293,923	6.4%	3.9%	10.4%	22%	37%

DRAFT

Ndryshimi 2013/2012	14%	101%	**36%**					

Tabela 2: Numri i pajtimtarëve me akses broadband dhe normat e penetrimit 2011-2013



Figura 5: Ecuria e numrit të pajtimatrëve me akses broadband 2007-2013

Numri i pajtimtarëve me akses broadband me rrjete fikse pati një rritje prej 14%, ku shumica e operatorëve kanë pasur rritje të numrit të pajtimtarëve. Albtelecom në 2013, pati rritje me 10% të numrit të pajtimtarëve broadband. Ndër operatorët alternativë fiks Abcom vazhdon të jetë operatori me numrin më të madh të lidhjeve broadband me rreth 43 mijë në fund të vitit 2013, që përbën një rritje prej 21% nga viti 2012. Rritje të madhe kanë pasur edhe Abissnet dhe ASC si dy operatorët e tjerë alternativë më të mëdhenj me 16% dhe 31% respektivisht.

	Albtelecom	**Abcom**	**Abissnet**	**ASC**	**OA te tjere**	**Total Broadband Fiks**
2010	70,597	13,575	7,000	5,666	23,162	120,000
2011	60,055	29,321	15,321	10,129	24,871	139,697
2012	66,757	35,870	17,719	11,777	27,965	160,088
2013	73,242	43,430	20,562	15,432	29,890	182,556
Ndryshimi	10%	21%	16%	31%	7%	14%

2013/2012						

Tabela 3: Numri i pajtimtarëve me akses broadband fiks 2010-2013

Numri i pajtimtarëve me akses broadband celular (3G me karta USB/modem për përdorim me kompjuter) në fund të vitit 2013 arriti në rreth 111 mijë nga 55 mijë në fund të 2012, që përbën dyfishim të numrit apo rritje me 101%. Të dy operatorët celularë Vodafone dhe AMC, kanë pasur rritje të ndjeshme me 76 dhe 80% respektivisht, dhe Eagle Mobile si operatori më i ri që filloi ofrimin e shërbimeve 3G në 2013, ka arritur të ketë rreth 13 mijë pajtimtarë gjatë vitit 2013. Rritje të madhe me 88% pati edhe numri i përdoruesve me akses broadband 3G nga aparatet celulare, duke arritur në rreth 1.1 milion në fund të 2013, krahasuar me 594 mijë në 2012. Në total numri i përdoruesve me akses broadband 3G (aparate celulare dhe karta USB) në 2013 arriti në 1.2 milion në krahasim me 694 mijë në 2012.

	AMC		**Vodafone**		**EM**		**Total**	
	USB/ Modem	**Aparat celular**	**USB/ Modem**	**Aparat celular**	**USB/ Modem**	**Aparat celular**	**USB/ Modem**	**Aparat celular**
2011	**9,000**	46,000	**25,493**	202,756	**N/A**	N/A	**34,493**	248,756
2012	**17,833**	222,882	**37,572**	371,426	**N/A**	N/A	**55,405**	594,308
2013	**32,138**	279,428	**66,086**	568,207	**13,143**	272,257	**111,367**	1,119,892
Ndryshimi 2013/2012	**80%**	25%	**76%**	53%	**N/A**	N/A	**101%**	88%

Tabela 4: Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G 2010-2013

1.2.1.2 Shërbimi Universal

Kuadri rregullator i BE-së në lidhje me shërbimin universal është përfshirë në DSHU, e cila fillimisht doli në vitin 2002 dhe u rinovua në vitin 2009. Kapitulli V i Ligjit 9918 (i ndryshuar) përfshin dispozita të shërbimit universal dhe është hartuar në përputhje të plotë me dispozitat kryesore të DSHU (versionin origjinal të 2002 dhe ndryshimet e 2009).

Parimet për Shërbimin Universal

DRAFT

Këto parime janë përmbledhur më poshtë:

Zgjidhjet e Tregut. Kur është e mundur, mekanizmat e tregut duhet të jenë mënyra e preferuar e plotësimit të objektivave të shërbimit universal. Ndërhyrja rregullatore në formën e vendosjes së një regjimi të përcaktimit të detyrimit të shërbimit universal të bazuar në përputhje me DSHU, duhet të konsiderohet me kujdes bazuar në kushtet kombëtare dhe statusin e sektorit. Çdo ndërhyrje e tillë duhet të bazohet në një vlerësim që ka përfitime neto në krahasim me alternativën e zgjidhjeve të tregut.

Çdo ndërhyrje duhet të jetë në proporcion me kushtet kombëtare**. Parimi i proporcionalitetit** është një faktor kyç në vlerësimin kosto/ përfitim për krijimin e një regjimi të shërbimit universal në përputhje me DSHU. Vendet Anëtare të BE që kanë pasur sukses në lidhje me kërkesën për kompensim ose në përdorimin e mekanizmave të financimit të shërbimit universal (FSHU) janë kryesisht vende me popullsi shumë më të madhe dhe me të ardhura më të larta se Shqipëria. Në këtë mënyrë AKEP gjykon përdorë një prag relativisht të lartë për caktimin e detyrimeve të shërbimit universal pasi këto mund të kërkojnë krijimin e një mekanizmi kompensimi.

DSHU duhet të implementohet duke reflektuar statusin kombëtar të sektorit. Në këtë aspekt, duke marrë parasysh kushtet kombëtare dhe konsideratat administrative vendet e BE-12 (të futur më vonë në BE) dhe rajonit SEE (CPC-9) mund të jenë relativisht më të krahasueshme me Shqipërinë. Në disa prej këtyre vendeve ku janë caktuar ofrues të Shërbimit Universal, (p.sh. Republika Çeke, Rumania dhe Mali i Zi) ato kanë vendosur që disa shërbime të ofruara nga vendndodhje fikse nëpërmjet rrjeteve celulare plotësojnë gjithashtu kriteret e elementit të shërbimit universal për akses dhe shërbim nga vendndodhje fikse.

Siguri ligjore dhe korrektësi procedurale. Nga përvoja ndërkombëtare vihet re se zbatimi i DSHU ka qenë objekt i vonesave administrative dhe apelimeve gjyqësore në lidhje me përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal, llogaritjen e kostove neto të DSHU dhe pagesën në mekanizmin e kontributit të sektorit. AKEP gjykon që në përputhje me praktikën ndërkombëtare dhe rajonale, të pergatiten rregullore që do të plotësojnë parashikimet e ligjit 9918, të ndryshuar, per sherbimin universal (rregulloret e Shërbimit Universal).

Ndryshimet ligjore të miratuara në vitin 2012, kanë krijuar hapësirë për përfshirjen në shërbimin universal të broadband. Gjithashtu në këto parashikime përcaktohen disa kërkesa për aksesimin e TIK nga grupe të ndryshme shoqërore si për pajisjet fundore dhe për ofrimin e tarifave të përballueshme.

DRAFT

1.2.1.3 Administrimi domain cc.TLD.al, nën domain-et e tij, si dhe ENUM:

Gjatë vitit 2013 u realizua kalimi nga sistemi Regjistër-Regjistrues. Me Vendimin nr.2252, datë 23.01.2013 Këshilli Drejtues i AKEP miratoi dokumentin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2, per "Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al". Këto ndryshime liberalizuan tregun e regjistrimit të domain nën .al duke kaluar nga sistemi Registry-Registrar vetëm AKEP në sistemin Registry AKEP dhe regjistrari i liberalizuar duke i dhënë të drejtën e regjistrimit edhe subjekteve të tjera të certifikuar nga AKEP bazuar në kriteret e vendosura në këtë dokument rregullator. Ky proces u realizua nëpërmjet këshillimit publik me sipërmarrësit.

Ka vazhduar procesi i regjistrimit të domain-eve nga AKEP në zonën .al duke plotësuar funksionin e regjistruesit.

- Nr. i domain-eve të regjistruar për vitin 2013 është **3320,** dhe kemi **12888** domain-e të regjistruar në total.
- Është bërë menaxhimi dhe mirëmbajtja e root server-ave të .al, procesimi i aplikimeve kryesisht për regjistrim dhe modifikim teknik në përputhje me Rregulloren nr.2 Për Regjistrimin e domain-eve nën zonën .al dhe nën domain-eve .gov.al, .edu.al, .org.al, .com.al, .mil.al, .net.al.

1.2.2 SHOQËRIA E INFORMACIONIT

Qeveria Shqiptare në fushën e shoqërisë së informacionit, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga neni 70 mbi përfarimin e legjislacionit si dhe neni 103 "*Shoqëria e Informacionit*"[2] të MSA-së, vëmendje të veçantë i ka kushtuar plotësimit të kuadrit ligjor dhe atij institucional në përputhje me standartet evropiane.

E ndërgjegjshme për rolin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në zhvillimin e shoqërisë dhe rritjen ekonomike, promovimin e pjesmarrjes gjithëpërfshirëse si dhe promovimin e qeverisjes efiçente, duke respektuar dhe kontribuar rrjedhimisht në përmbushjen e parimeve bazë që shërbejnë për një demokraci cilësore, shtet të së drejtës

[2] Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetite për shoqërinë e informacionit. Ai mbështet kryesisht orientimin gradual të politikave dhe legjislacionit të Shqipërisë për këtë sektor me ato të Komunitetit.

funksionale, politikë përfaqësimi transparente, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një sërë reformash për zhvillimin e shoqërisë së informacionit.

Legjislacioni evropian (*acquis e BE)* për shoqërinë e informacionit synon të eliminojë pengesat për një funksionim efektiv të tregut të brendshëm në shërbimet dhe rrjetet e komunikimit elektronik, të nxisë konkurrencën dhe të mbrojë interesat e konsumatorit në këtë sektor, përfshi disponibilitetin universal të shërbimeve bashkëkohore bazë. *Acquis* e Bashkimit Evropian përfshin gjithashtu rregulla trasparente për shërbimet e shoqërisë së informacionit.

AKSHI, si një agjenci e specializur për e-qeverisjen dhe shoqërinë e informacionit ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm në zbatimin e strategjisë ndërsektoriale dhe në zhvillimin e shoqërisë së informacionit.

AKSHI përmes qendrës së të dhënave qeveritare ofron një numër shërbimesh të përqëndruara për institucionet publike. Kjo qendër është ngritur pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), sipas standardeve bashkëkohore të kushteve për serverat dhe mundëson që të gjitha shërbimet online qeveritare të jenë të qendërzuara e të integruara.

Aktualisht AKSHI ofron shërbime të qendërzuara për rreth 200 institucione publike pa pagesë. Për një kohë të shkurtër, nga krijimi deri tani numri i institucioneve që marrin sot shërbim nga AKSHI është rritur me 10 herë, po kështu volumi i shërbimeve të ofruara është rritur ndjeshëm si psh:

- Autentifikim dhe identifikim të sigurtë – për 25 institucione, 2500 përdorues;
- Postën elektronike qeveritare – 110 institucione (E- mail: për 11 000 përdorues)
- Internet të sigurtë për 65 institucione;
- Shërbimet hosting për sisteme, pajisje, aplikime, faqe/portale web, - 150 institucione, etj.
- Licensim qendror i sistemeve operative Microsoft – 200 insitucione;
- Instalim automatik dhe qendror i aplikimeve – 2000 PC të Ministrive që janë në domain;
- Update të sistemeve klient dhe server – 2100 makina klientë dhe server;
- Menaxhim qendror i mbrojtjes antivirus – 7 institucione, 1000 kompjutera;

DRAFT

- Platforma qeveritare e ndërveprimit (Government Gateëay) – aktualisht të lidhura 7 sisteme dhe janë në proces 10 sisteme/databaza shtetërore; (Komunikimi në Government Gateëay; Publikimi në portal;)
- Shërbimi i hostimit të zonave të domaineve qeveritare: 230 zona;
- Shërbimi i kolokimit fizik – 20 Institucione;
- Komunikim tekst i menjëhershëm, zanor dhe video – Lync 2013 rreth 300 përdorues, në implementim për të gjithë domain users;
- e-signature përmes Infrastrukturës Qeveritare të Çelësit Publik (PKI) – 2 institucione;
- Lidhje e Institucioneve në rrjetin qeveritar: me link fibër të dedikuar – 200 institucione.

Në bazë të Ligjin Nr. 10 325, datë 23.09.2010 "Për Bazat e të Dhënave Shtetërore" AKSHI në tagrin e ARK (Autoriteti Rregullator Koordinues), ushtron kompetencën e tij në institucionet publike që krijojnë dhe administrojnë një bazë të dhënash shtetërore, si dhe çdo person juridik privat në kuadër të bazave të të dhënave shtetërore, që ushtron funksion publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Regjistrimi dhe ndërveprimi i të gjitha bazave të të dhënave shtetërore, kërkon një angazhim serioz nga të gjitha institucionet aktualisht administruese të bazave të të dhënave shtetërore për të bashkëvepruar në arritjen e një qëllimi madhor: regjistrimi dhe koordinimi i bazave të të dhënave shtetërore, shmangia e investimeve të dubluara, realizimi i unicitetit të të dhënave, zbatimi i standardeve të miratuara për databazat shtetërore.

Ecuria e indikatorëve IDI, IPB, NRI dhe e-government në periudhën 2002-2013

Bazuar në raportet periodike të ITU-së "Information Society Measurement", në raportet periodike të "The Global Information Technology report" si dhe në raportet periodike të UNPAN mbi e-government, më poshtë prezantohet ecuria e këtyre indikatorëve:

- IDI – indeksi i zhvillimit të TIK
- IPB- indeksi i shportës së çmimeve në TIK
- NRI- indeksi i gadishmërisë së rrjetit
- e-government index- indesi i gadishmërise për e-qeverisjen
- e-participation indeks – indeksi i pjesëmarrjes në vendimmarrje

INDEKSI I ZHVILLIMIT TË TIK (IDI)

Ecuria & krahasimi me mesataren botërore dhe Europiane

Indikatori IDI është indikator kompozitë me tre nëngrupime/nënindikatorë që përfshijnë 11 indikatorë individualë. Metodologjia e llogaritjes jepet në raportin e ITU-së "Information Society Measurement".

Në grafikun e mëposhtëm prezantohet ecuria në periudhën 2002-2012 e këtij indikatori për Shqipërinë dhe e krahasuar me mesataren rajonale dhe atë botërore.



Figura 6 Indikatori IDI 2002-2012

Burimi: ITU, Raportet "Information Society measurement" 2010-2013

Siç shihet indeksi IDI për Shqipërinë pavarësisht se ka rritje vit pas viti mbetet nën mesataren botërore dhe e fundit për rajonin e Europës. Në rang botëror Shqipëria bën pjesë në grupin e vendeve me rezultat mesatar të këtij indeksi dhe është afër kufirit të sipërm për të kaluar në grupin e vendeve me rezultat mbi mesatar.

Nivelet: ulët, mesatar, mbi mesatar, lartë Indeksit IDI

	2007		Nr. vendeve	2008		Nr. vendeve	2012		Nr. vendeve
	Min.	Max.		Min.	Max.		Min.	Max.	
Lartë	5.29	7.50	33	5.67	7.85	33	6.19	8.57	40
Mbi mesatar	3.41	5.25	33	3.64	5.64	33	4.17	6.11	39

Mesatar	2.05	3.34	44	2.16	3.54	47	2.40	4.11	39
Ulët	0.82	2.03	44	0.79	2.04	46	0.99	2.33	39

Tabela 5 Indeksi IDI në nivel botëror

Ndërkohë, të gjitha vendet evropiane kanë një vlerë të indeksit IDI sipër mesatares globale dhe rreth gjysma e tyre e kanë indeksin IDI sipër mesatares së vendeve të zhvilluara 6.78. Megjithatë në raportet e viteve të fundit për Shqipërinë thuhet se është ndër vendet me rritjen me të madhe të nënindeksit të aksesit dhe nënindeksit të përdorimit (kjo e fundit jepet në raportin e ITU, MIS/2013).

Për të kuptuar se cilat janë faktorët që ndikojnë tek niveli IDI në tabelën e mëposhtme është bërë një krahasim i nënindekseve të IDI:

- Nënindeksi i aksesit përfshin:
  - penetrimin e telefonisë fikse, celulare, bandwidth ndërkombëtar (konektiviteti) për përdorues interneti
- Nënindeksi i përdorimit përfshin:
  - % e familjeve me PC, % e familjeve me Internet, Përdorues Interneti, penetrimin e pajtimtarëve broadband fiks, penetrimin e pajtimtarëve broadband wireless
- Nënindeksi i aftësive përfshin:
  - % e regjistruar në shkollë të mesme, % e regjistruar në shkollë të lartë, të shkolluarit

	2002		**2007**		**2008**		**2012**	
	Mes. Bot..	**Shqipëria**	**Mes. Bot**	**Shqipëria**	**Mes. Bot**	**Shqipëria**	**Mes.Bot**	**Shqipëria**
IDI	2.48	1.92/93	3.40	2.73/85	3.6	3.12/84	4.35	4.11
Access sub index	2.68	1.87/ 78	3.91	2.83/96		3.27/88	4.74	3.73/96[3]
Usage sub index	0.54	0.01/ 130	1.43	0.63/78		0.91/84	2.85	2.71/65

[3] *Raporti i mëparshëm dhe raporti i vitit 2013 kanë diferenca. Raporti 2013 e jep vitin 2011 në të njëjtën renditje vendi 96 me 3.55 në të vërtetë raporti 2012 ka qëne si në tabelen më sipër.*

DRAFT

Skills sub index	5.95	5.82/92	6.31	6.69/ 78	7.25/64	6.59	7.65/57

Tabela 6 Nënindekset IDI në periudhën 2002-2012

Burimi: ITU, Raportet "Information Society measurement" 2010-2013

Vërejmë se nga studimi i raporteve të njëpasnjëshme rezultatet e llogaritura nga ITU nuk janë konsistente dhe kanë ndryshime.

Grafiku i mëposhtëm jep të detajuar peshimin e secilit nga 11 ndikatorët mbi të cilët llogaritet indeksi IDI me rezultatin maksimal të vendosur si target për indikatorin (treguesi maksimal ndryshon psh "bandwidthi për internetin ndërkombëtar është rritur me disa herë nga 2010-2013).



Figura 7 **Paraqitja grafike e nënindekseve të IDI për Shqipërinë në periudhën 2002-2012**

Burimi: Ndërtuar sipas të dhënave dhe metodologjisë së ITU

Është e dukshme se:

- nënindeksi i peshuar për penetrimin e telefonisë fikse mbetet pothuajse në të njejtin nivel në periudhen 2002-2012.
- nënindeksi i peshuar për % e familjeve me PC dhe me lidhje Internet mbetet i ulët
- nënindeksi i peshuar për lidhjet fikse broadband mbetet tepër i ulët (ka varësi me penetrimin e ulët të telefonisë fikse).

Vëmë në dukje se raporti i ITU-së për vitin e kaluar ka pasur një konstatim të gabuar për tregun e telefonisë celulare në Shqipërisë (s'ka arritur ende maturimin) – gjë që reflektohet dhe në grafikun e mësipërm. Në të vërtetë penetrimi i telefonisë celulare është në kufirin e sipërm të përdorur si tregues maksimal për peshimin e këtij nënindeksi (190%).

INDEKSI - Çmimi i Shportës së TIK (IPB)

Treguesi **Çmimi i Shportës së TIK** është gjithashtu një indikator kompozitë, i ndërtuar mbi bazën e llogaritjeve për tre nënshporta:

- nën shporta e telefonisë fikse
- nën shporta telefonia celulare
- nën shporta e Internetit

Sipas raportit të ITU-së për vitin 2013, IPB për Shqipërinë rezulton:

- Shqipëria renditet në vendin e 100 me vlerën e IPB në 4.5% kundrejt GDP/p.c. me një përmirësim të vogël nga 4.6% e GDP/p.c në vitin 2011.
- Nënshporta për telefoninë fikse është 2.2 % kundrejt GDP/p.c në krahasim me 2.3% të GDP/p.c në 2011,
- Nënshporta për telefoninë celulare është 7.8% kundrejt GDP/p.c në krahasim me 7.9% të GDP/p.c në 2011.
- Nënshporta për fiks broadband jepet 3.6% të GDP/p.c.

Cmimet e Mobile broadband

Në 2012, për herë të parë ITU mblodhi të dhëna mbi çmimet e mobile-broadband përmes pyetësorit të TIK Price Basket.

- Shqipëria është në vendin 34 me 1.5 % të GDP/p.c, shërbimin prepaid dhe në vendin e 46 me 1.5 % të GDP/p.c për postpaid për 500MB nga celulari.
- Shqipëria është në vendin 28 me 1.6% të GDP/p.c për marrjen e Internetit mobile broadband nga kompjuteri për prepaid dhe në vendin e 85 me 5.1% të GDP/p.c për marrjen e internetit në 1GB nga kompjuteri (postpaid).

DRAFT

Në tërësi çmimet e mobile broadband për 500 MB si për paketat prepaid dhe për ato postpaid krahasuar me vëndet e tjera si në rajon dhe në rang global janë në nivele të ulta (të përballueshme) gati në nivelin e vendeve të zhvilluara. Ndersa shërbimi për mobile broaband në 1 GB është në nivel mesatar krahasuar me vendet e tjera.

INDEKSET E-GOVERNMENT DHE E-PARTICIPATION

Raportet periodike të UNPAN (Rrjeti i Administratës Publike të UN)[4] bëjnë një vlerësim të e-government readiness index, dhe e-participation. Edhe keta indikatorë janë të përbërë dhe marrin në konsideratë dhe infrastrukturën dhe vrojtimet në web. Rezultate për web akses dhe shërbimet online nxirren mbi bazën e vrojtimit në mënyrë të pavarur të faqeve zyrtare të internetit. .

Në tabelat e mëposhtme jepet ecuria e këtyre indikatoreve për Shqipërinë.

Year	2003	2004	2005	2008	2010	2012	2014
e-government Index	0.311	0.340	0.3732	0.4670	0.4519	0.5161	0.5046
Web measurement Subindex/online service	0.083	0.162	0.1615	0.3913	na	0.425	0.4488
Telecommunication SubIndex/infrastructure	0.049	0.058	0.068	0.1251	na	0.337	0.3548
Human Capital Sub index	0.80	0.80	0.89	0.8869	na	0.7863	0.7100

Tabela 7 e-government index i Shqipërisë në periudhën 2003-2012[5]

Burimi: UN reports

Krahasimi me rajonin dhe mesataren botërore për e-gov indeks:

	2014	2012	2010
Shqipëria	0.5046	0.5161	0.4519

[4] *http://unpan3.un.org/egovkb/ProfileCountry.aspx?ID=2*

DRAFT

Mes. Europa	0.6936	0.6574	0.5566
Mes. botërore	0.4712	0.4882	0.4406

Tabela 8 Krahasimi me rajonin dhe mesataren botërore për e-gov indeks

Me këtë tregues jemi mbi mesataren botërore por poshtë mesatares Europiane.

Year	2003	2004	2005	2008	2010	2012	2014
e-participation Index	0.017	0.0328	0.0317	0.0227	0.1286	0.105	0.5294

Tabela 9- e-participation index për Shqipërinë

Burimi: UN reports

Vërejmë se në raportet periodike raportet e UN kanë pasur dhe ndryshime të metodologjisë, gjë që mund të ketë ndikuar dhe në rezultatin me ulje të indikatorit për e-participation.

Në lidhje me e-participation ka një rritje (ka ndryshim të metodologjisë). Në renditje Shqipëria është në vendin e 59 sipas UNPAN 2014.

1.2.3 KËRKIMI SHKENCOR DHE INOVACIONI

Politikat e ndërmarra në fushën e kërkimit shkencor kanë mundësuar reformimin e këtj sektori të rëndësishëm për ekonominë dhe zhvillimin e vendit. Përmirësime të ndjeshme janë arritur në kuadrin ligjor dhe institucional me miratimin e ligjit mbi Arsimin e Lartë dhe rishikimin e Ligjit mbi Akademinë e Shkencave. Reformimi i Akademisë së Shkencave mundësoi integrimin e instituteve të kërkimit të Akademisë së Shkencave dhe të ministrive të linjës në universitetet publike. Sistemi i arsimit të lartë u integrua me sistemin e kërkimit shkencor duke krijuar një kuadër modern institucional për një zhvillim të shpejtë të kërkimit shkencor dhe të transferimit të teknologjive e të njohurive.

Progres është arritur në menaxhimin strategjik dhe operacional të programeve të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik (RTD) përmes krijimit të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI);

Është rritur pjesëmarrja me projekte nga institucionet shqiptare të kërkimit shkencor në programet komunitare dhe ato ndërkombëtare si dhe mbështetja me financim publik në kuadër të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit. Qeveria shqiptare mobilizoi fonde nga buxheti i shtetit dhe u akordoi 550 vende të reja pune dhe mbështeti doktorantët më të mirë nëpërmjet programit Brain Gain dhe Fondit të Ekselencës.

Sfidat e mëtejshme lidhen me reformat e reja që po bën Qeveria në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor e Inovacionin duke synuar në: (i) zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor e inovacionit në Shqipëri bazuar në treguesit e OECD; (ii) përfshirjen më aktive të institucioneve të kërkimit shkencor shqiptar në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA), (iii) përmirësimin e cilësisë dhe orientimin e kërkimit shkencor drejt nevojave të tregut nëpërmjet forcimit të lidhjeve të Programeve Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë me biznesin.

1.2.4 PLANI KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN E BROADBAND

Plani Kombëtar për zhvillimin e broadbandit është një dokument strategjik për zhvillimin e infrastrukturës broadband dhe shërbimeve i miratuar me VKM Nr. 468 dt. 30.5.2013.Plani Kombëtar i Broadband-it është një zhvillim i rëndësishëm sepse jep një drejtim të qartë se çfarë do të bëjë Qeveria, administrata publike, rregullatori si AKEP në periudhën 2013-2020. Ai ofron një vizion se si do zhvillohet aksesi në internet duke u përdorur maksimalisht në familjet shqiptare edhe në zonat më të largëta.

Plani Kombëtar për Zhvillimin e Broadband-it përcakton si vizion zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve broadband në të gjithë vendin për të përftuar akses në shërbimet elektronike në fusha të ndryshme si shëndetësi (e-health), edukim (e-education), tregti (e-commerce), shërbimet qeveritare (e-government) si dhe për të arritur përfitime të mëdha ekonomike dhe sociale për vendin tonë.

Nëpërmjet shërbimeve broadband jo vetëm shpërndahet informacion me shpejt dhe më mirë për individët dhe bizneset, jo vetëm mbështetet një qeverisje më e mirë, por rritja e shkallës së penetrimit të broadbandit për çdo 10% është analizuar që sjell rritje ekonomike në GDP-në e një vendi nga 0.25% në 1.23%.

DRAFT

Në lidhje me implementimin e Planit Kombëtar të Broadbandit janë kryer disa aktivitete:

- Më 16 Maj 2014, Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike në bashkëpunim me AKEP organizuan një konferencë kombëtare mbi zhvillimin e broadbandit. Ministri dhe AKEP nënvizuan rëndësinë e broadbandit për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, rritjen e ndjeshme gjatë vitit të kaluar në penetrimin e mobile broadband dhe fiks broadband. Vunë theksin në nevojën për investime dhe kooperim të ngushtë ndërmjet sektorit publik e privat si kyc në progresin e mëtejshëm dhe arritjen e objektivave ambicioze.

- Disa konsultime publike janë organizuar nga AKEP vitit 2014 mbi cështjet e spektrit të tilla si:
    - Mbi refarming dhe implementimin e teknologji neutral në autorizimet individuale ekzistuese;
    - Mbi dhënien e autorizimeve individuale për spektirn e lirë të mbetur në brezat 2.1GHz dhe 1800 Mhz;
    - Tenderi për dhënien e autorizimeve individuale për spektrin e mbetur në 2.1GHz u hap në 15 Shtator dhe është në proces;
- Ne kuadrin e bashkepunimit me aktore te ndryshem eshte kërkuar nga Fondi Rajonal i Zhvillimit përfshirjen në projektet e zhvillimit rural dhe rajonal të projekteve për infrastrukturën TIK dhe e-government.
- Disa iniciativa dhe projekte janë ndërmarrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me MIAP në lidhje me e-learning, dhe përdorimin e TIK në edukim.
- Zhvillimi i e-qeverisjes është një proces i vazhdueshëm sikurse prezantoher ne kete dokument.

1.2.5 STRATEGJIA PËR KALIMIN NGA TRANSMETIMI ANALOG NË ATË DIXHITAL

Dhënia e të drejtave të përdorimit të frekuencave, të cilat janë një burim i kufizuar kombëtar më vlerë të konsiderueshme në ekonominë e një vendi, po bazohen në parimin e neutralitetit teknologjik, duke u dhënë hapësirën e duhur teknologjive më të zhvilluara broadband të komunikimeve të levizshme LTE/4G për t'u aplikuar në parametrat e tyre më të mirë.

Rol të rëndesishëm në këtë drejtim luan edhe lirimi i spektrit të quajtur Dividendit Numerik, një numër frekuencash të fituara si rezultat i dixhitalizimit të plotë të transmetimeve audiovizive. Dividendi numerik do të vihet në dispozicion të shërbimeve me brez të gjerë të komunikimeve të lëvizshme duke ndikuar në këtë mënyrë drejtëpërdrejtë në rritjen e aksesit broadband. Përpjekjet e Qeverisë janë fokusuar në zbatimin në kohë të Strategjisë për Kalimin nga Transmetime Analoge në Transmetime Numerike, pjesë e rëndësishme e të cilës është dhe lirimi i Dividendid Numerik dhe vënia e tij në përdorim të shërbimeve me brez të gjerë.

1.2.6 CERTIFIKIMI ELEKTRONIK

Nënshkrimi Elektronik në Shqipëri njihet ligjërisht që prej vitit 2008. Ligji nr. 9880, datë 25.02.2008 "Për nënshkrimin elektronik" dhe aktet të tjera nënligjore janë në përputhje me Direktivën Evropiane 1999/93/EC.

Nga viti 2009 funksionon Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE), i cili është Institucioni që ka përgjegjësinë e mbikëqyrjes së ligjit, akteve të tjera nënligjore, Specifikime të tjera Teknike të publikuara nga European Telecommunications Standards Institute (ETSI), si edhe standarde të tjera ndërkombëtare të fushës, të cilat janë të detyruara të përmbushen nga një Ofrues i Shërbimit të Certifikimit (OSHC), i cili lëshon certifikata elektronike të kualifikuara.

Çdo subjekt i cili kryen aktivitet në Republikën e Shqipërisë si OSHC duhet të zbatojë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Çdo OSHC i cili lëshon certifikata të kualifikuara elektronike duhet të regjistrohet/akreditohet pranë Autoritetit. Momentalisht vetëm OSHC të cilat lëshojnë certifikata të kualifikuara janë të detyruar me ligj të mbikëqyren nga AKCE.

Aktualisht pranë AKCE janë regjistruar dy OSHC:

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), e cila e ofron shërbimin për funksionarët publik. Ky shërbim është 100% i mundur dhe falas.

- ALEAT SHPK, i cili e ofron shërbimin për sektorin privat, në zbatim të kontratës koncesionare me Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Në kuadër të dixhitalizimit të shërbimeve të cilët i ofrohen qytetarëve, po i jepet shtysë përdorimit të nënshkrimeve elektronike për të lehtësuar përdorimin e tyre në distancë dhe garantuar sigurinë e nevojshme në to.

DRAFT

AKCE po punon në hartimin e një Ligji të ri për Nënshkrimin dhe Identifikimin Elektronik. Ky Ligj i ri lind si nevojë e përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga Rregullorja Evropiane *No 910/2014 of the European Parliament and of the Council of 23 July 2014 on electronic identification and trust services for electronic transactions in the internal market and repealing Directive 1999/93/EC*. Kjo Rregullore paraqet koncepte të reja si Identifikimi Elektronik, Vula Elektronike, Certifikata Elektronike për servera web, etj. Pas miratimit të draft ligjit të ri, në Shqipëri do të ketë një kuadër ligjor më të plotë për njohjen e këtyre shërbimeve të besueshme dhe akreditimin, mbikëqyrjen e subjekteve (Ofruesve të Shërbimit) të cilët i lëshojnë e mundësojnë ato. Brenda vitit 2015 pritet që të plotësohet kuadri ligjor dhe teknik në këtë fushë.

1.2.7 TEKNOLOGJITË E INFORMIMIT E TË KOMUNIKIMIT NË ARSIM

Qëllimi kryesor i shtrirjes së Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit në shkolla është rritja e cilësisë ne mësimdhënie dhe përgatitja e nxënësve më aftësitë e duhura të qytetarisë digjitale për të qenë i aftë të studiojë, kërkojë dhe punojë në një botë te drejtuar gjithnjë e më shumë nga informatizimi i proceseve dhe shërbimeve.

Sot në sistemin tonë arsimor parauniversitar kemi 1496 laboratorë kompjuterësh. Rrjeti i internetit është instaluar në shkolla duke u mundësuar nxënësve dhe mësuesve të përdorin burime të ndryshme informacioni dhe në veçanti, të punojnë me projekte kurrikulare. Çdo shkollë ka lidhje të dedikuar broadband vetëm në ambjentet e laboratorëve kompjuterikë.

Lënda e TIK-ut është shtrirë edhe në arsimin bazë, krahasuar me vitin 2006 që zhvillohej vetëm në shkollë të mesme. Ajo vazhdon në klasën e VII-të dhe shtrihet deri në klasën e XII-të.

Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në arsim do të bente të mundur zhvillimin, planifikimin e politikave arsimore në mënyrë më efikase dhe bazuar në të dhëna. Ai do të rriste ndjeshëm cilësinë e shërbimit dhe eliminimin e dublikimit të informacionit; do të rriste transparencën dhe do të pakësonte burokracinë administrative, do të zvogëlonte ndjeshëm kohën për përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave, do të ulte kostot për transaksionet financiare si dhe do të rriste eficencën në menaxhimin e burimeve të strukturave arsimore.

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) i cili do të përmbante bazën e të dhënave të nxënësve bashkë me nr. e amzës dhe notat e dëftesave, si dhe bazën e të dhënave të mësuesve me informacion rreth aftësive dhe njohurive të stafit mësimdhënës, sot aktualisht nuk është funksional.

Baza Elektronike e të dhënave të arsimit të lartë (DBAL), që përfshin Regjistrin Kombëtar të Studentëve, i cili synonte pajisjen me numrin kombëtar të identifikimit të çdo studenti të regjistruar në çdo shkollë të lartë, publike apo private, në të tri ciklet e studimeve universitare, megjithëse ekziston, paraqet aktualisht shumë problematika GIS & SIMS (TA-ALB-10) Moduli GIS (Geographical Information System) që do të ndihmonte strukturat vendimmarrëse në arsim dhe autoritet e njësive vendore rreth sistemit arsimor, pozicionit gjeografik të objekteve arsimore dhe nevojat e tyre, përfaqëson një sistem të përditësuar me të dhënat aktuale dhe të pamirëmbajtur.

Moduli Financiar që menaxhon financat dhe buxhetin e institucioneve arsimore në nivel qendror dhe lokal funksionon vetëm pjesërisht në disa DAR-e.

Investimet në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore për t'i përdorur këto sisteme ka qenë tepër i reduktuar dhe kjo ka ndikuar në një shkallë përdorimi të reduktuar të tyre.

Në vitin 2012 u realizua me sukses pilotimi i Sistemit online të Maturës Shtetërore për aplikimin me formularin A2, shpërndarjen e fituesve sipas parimit Meritë-Preferencë si dhe regjistrimi online i studentëve në universitete në të dyja fazat e raundit të parë.

Për të

Per te gjitha shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, publike, pajisjet TIK (Desktop, Laptop, Videoprojektor, printer, fotokopje) të furnizuara ndër vite kanë patur si kriter bazë numrin e nxënësve sipas viteve dhe totalit për shkollat.

Vlerat kufi të nxënësve për shpërndarjen e laboratorëve kompjuterike, përkatësisht me 5 desktop për nxënësit dhe një për mësuesin; 10 desktop për nxënësit dhe një për mësuesin; si dhe 15 desktop për nxënësit dhe një për mësuesin, kanë qenë deri në 300, nga 300 deri në 600 dhe mbi 600 nxënës. Pajisjet sipas konfigurimeve të mësipërme janë të lidhura në rrjete të brendshme kabllore me Switch, pa ndonjë program menaxhimi, apo aplikacion për përmbajtjen lëndore.

Pajisjet desktop, laptop, printer, e fotokopje duke qenë se janë furnizuar të shpërndarë në kuadër të projekteve të ndryshme, me financues e donatorë vendas e të huaj, paraqesin

DRAFT

gjendje faktike me probleme (shumë prej tyre ose kanë nevoja për riparime, ose janë plotësisht të konsumuara.

Konstatohet se:

- raporti numër kompjuterësh në përdorim për nxënës, ndryshon nga shkolla në shkollë. Afërsisht, ky raport është 1:27 ose më keq;
- nxënësit mund të marrin informacion vetëm në laboratorët kompjuterikë, por jo në mjedise të tjera të shkollave si, p.sh., biblioteka;
- në më shumë se 1/3 e shkollave, nxënësit kanë mundësi të kufizuara për marrjen e informacionit online;
- mungojnë plotësisht përmbajtjet dixhitale në gjuhën amtare; shfrytëzohen vetëm përmbajtje nga interneti, që dallojnë nga burimi i shfrytëzuar;
- është shfaqur rreziku i ekspozimit përballë përmbajtjeve të papërshtatshme;
- nuk ka ndërgjegjësim të fëmijëve në përdorimin e internetit për dukuri si Cyberbulling ose Grooming online.
- Me gjithë investimet e bëra, përdorimi i TIK-ut në institucionet arsimore është i kufizuar. Pajiset e ofruara me financime publike në pjesën më të madhe nuk shfrytëzohen ose kanë dalë jashtë inventarëve. Nga shkollat e arsimit bazë publik, raportohen 15731 PC, nga të cilët 11331 janë funksionalë, ndërsa 4400 PC janë jofunksionalë. Shkollat raportojnë 1631 laptopë, nga të cilët 432 janë jashtë funksionit.

1.2.8 QEVERISJE E HAPUR NËPËRMJET PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJISË

Pak pas lançimit zyrtar të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur, Qeveria Shqiptare mbështeti vlerat e promovuara nga kjo iniciativë shumëpalëshe. Partneriteti për Qeverisjen e Hapur (PQH-OGP) është një ndër instrumentët më të rëndësishëm për të nxitur transparencën qeveritare në nivel global, për të rritur pjesëmarrjen qytetare në jetën publike dhe për të përdorur teknologjitë e reja për të përmirësuar efiçencën administrative dhe luftuar korrupsionin

Plani i parë i Veprimit për 2011-2013 i PQH-OGP u fokusua kryesisht në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në menaxhimin e shërbimeve të burimeve publike, duke zbatuar masat në

fushën e transparencës fiskale, qasjen në informacion, përdorimin e teknologjisë së informacionit (IT) dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e zhvillimit të politikave publike.

1.2.9 INFRASTRUKTURA PËR INFORMACIONIN GJEOHAPSINOR

Axhenda Dixhitale e Shqipërisë është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare. Realizimi i këtij objektivi është një sfidë e madhe e lidhur ngushtë me Informacionin Gjeografik(GI) dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore. Është e veshtirë të flasësh për iniciativa si e-Government apo për zhvillimin e shoqërisë së informacionit pa GI dhe shërbime të të dhënave gjeohapësinore në përputhje me standardet dhe rregullat e BE-së

Në objektivat dhe realizimet më të rëndësishme është koordinimi ndërinstitucional, me qëllim mundësimin e grumbullimit të të dhënave për gjeoinformacionin egzitues dhe vënia në dispozicion të publikut dhe të institucioneve shtetërore të interesuara të këtij informacioni, nëpërmjet Gjeoportalit kombëtar. Në këtë organizim të rëndësishëm të shërbimit online, janë përfshirë temat e parashikuara në ligjin organik 72/2012, me prioritet temat si Hartat Topografike, ortoimazheria për të gjithë teritorin e vëndit, harta e kufijve kadastral, harta treguese e pasurive të paluajtëshme, harta e vlerës së pronës(tokes).Këto tema do të përbëjnë strukturën kryesore të të dhënave për realizimin e gjeoportalit, duke e plotësuar në vijim me të gjitha komponentet e saj.

Ky aktivitet i rëndësishëm shërbimesh online, është shoqëruar me përgatitjen e infrastrukturës përkatëse të Informacionit Gjeografik, ku janë përfshirë përgatitja e termave të references për Hardware dhe Software, hartimi datamodelit për të dhënat egzistuese gjeohapsinore si dhe përgatitja e gjeoportalit paraprak për shfaqen e të dhënave egzistuese.

Infrastruktura Kombetare e të Dhënave Hapsinore (NSDI) përfaqëson një sistem të integruar të dhënave gjeohapësinore, duke u bërë të mundur përdoruesve për të identifikuar dhe përdorur informacionin hapësinor të mbledhur nga burime të ndryshme, nga ai lokal, si dhe nëpërmjet atij kombëtar për nivel global, në mënyrë gjithëpërfshirëse. Qëllimi i krijimit të NSDI-së në vendin tonë është të përmirësojë veprimet e çdo institucioni, të reduktojë kostot, të lehtësojë analiza të hërëpasherëshme dhe të çojë në vendimmarrje të përbashkëta duke ofruar një seri të dhënash të gatshme gjeografike dixhitale bazë. Infrastruktura konsiston në të

dhënat që u nevojiten, i përdorin dhe i prodhojnë të gjithë, të sjella në një standard të përbashkët, dhe të bëra të aksesueshme prej të gjithëve.

Krijimi i Gjeoportalit Kombëtar, është një risi e një rëndësie të veçantë në aspektin e shërbimit online,të informacionit Hartografik dhe gjeoinformacionit së bashku me databazën. Vendosja e këtij shërbimi për herë të parë në Shqipëri, bënë të mundur unifikimin e informacionit në bazë të standarteve të "INSPIRE", shmang mbivendosjet në marrëdhëniet e pronësisë, eliminon burokracinë e komunikimit dhe e bënë më të lehtë përdorimin.

1.2.10 SITUATA NË FUSHËN E TIK-UT NË SEKTORIN SHËNDETËSOR

Menaxhimi i mirë i sistemit shëndetësor kërkon detyrimisht një sistem informacioni modern dhe funksional i cili iu përgjigjet sfidave aktuale dhe trendeve të ardhshme të sektorit shëndetësor. Informacioni shëndetësor, klinik dhe jo-klinik është thelbësor për politike-bërje, planifikim dhe programim. Informacioni shëndetësor është mbi të gjitha instrumenti kryesor i monitorimit dhe vlerësimit të performancës së sistemit shëndetësor në një klimë transparence dhe përgjegjshmërie. Qasja e duhur për përmirësimin e sistemit te informacionit është informatizimi i tij dhe në këtë kuadër, MSH dhe institucionet e tjera të sektorit shëndetësor, në këto vite kanë realizuar një sërë ndërhyrjesh dhe investimesh të rëndësishme në fushën e Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit.

Konkretisht, në kujdesin shëndetësor parësor që përbëhet nga rreth 418 Qendra Shëndetësore (QSH), janë realizuar disa investime të rëndësishme në këtë fushë. Vlen të përmendet plotësimi i të gjithë këtyre qendrave me kompjutera dhe printera si dhe instalimi i një programi kompjuterik për hedhjen e të dhënave të mbledhura nga dy formularët bazë (formulari i vizitës dhe formulari i procedurave mjekësore) që plotësohen nga infermierët dhe mjekët për çdo vizitë që kryhet pranë këtyre qendrave. Sistemi është implementuar nga FSDKSH dhe MSH me mbështetjen e USAID. Aktualisht një pjesë e konsiderueshme e QSH përpunojnë vetë informacionin e tyre nga operatorët përkatës direkt në QSH. Në vijim FSDKSH planifikon të pilotojë në nivel mjeku shtrirjen e këtij sistemi.

Në kujdesin shëndetësor dytësor (që përbëhet nga rreth 39 poliklinika 40 spitale) dhe atë terciar (6 spitale universitare), janë bërë gjithashtu investime të rëndësishme. Konkretisht, në Qendrën Universitare Nënë Tereza në Tiranë (QSUT) është implementuar sistemi kompjuterik "Sistemi i Informacionit për shëndetin Publik" **(SISP)** ku është bërë i mundur informatizimi i recepsioneve për regjistrimin e të gjithë pacientëve që marrin shërbim në këtë

qendër si dhe informatizimi i menaxhimit të medikamenteve. Në vijim pritet shtrirja e këtij sistemi në të gjithë shërbimet e tjera të kësaj qendre. Gjithashtu ky sistem është implementuar edhe në recepsionet e spitalit Universitar Obsetrik Gjinekologjik Koço Glozheni, Spitalit Universitar të Mushkërive Shefqet Ndroqi, Spitalit Rajonal Durrës, Korçë dhe Shkodër.

Gjithashtu një tjetër investim i rëndësishëm në dy spitalet universitar Obstetrikë Gjinekologjik në Tiranë (Mbretëresha Gardalinë dhe Koço Glozheni), në maternitetin e Durrësit, Korçës dhe Elbasanit është implementimi i programit kopjuterik obsetrik-gjinekologjik klinik **ASTRAIA** që bën të mundur informatizimin e të gjitha të dhënave mjekësore.

Ndërhyrje të tjera të rëndësishme në fushën e TIK-ut në sektorin shëndetësor janë edhe:

Projekti i Telemjekësisë

Projekti i Telemjekësisë së Shqipërisë është gjithashtu një nga arritjet në fushën e Shëndetësisë në shërbim të zhvillimit bashkëkohor të saj në funksion të qytetarit Shqiptar për një diagnozë më të shpejtë, më të saktë dhe një trajtim bashkëkohor. Gjithashtu, ky program përbën një arritje në fushën e edukimit në vazhdim, një nga prioritetet madhore të sistemit shëndetësor, duke ofruar mundësitë dhe njohuritë më bashkëkohore në shëndetësi.

Që nga korriku i vitit 2012, rrjeti i integruar i telemjekësisë konsiston në Qendrën Kombëtare të Telemjekësisë e vendosur në QSUT, dy qendra telemjekësie të vendosura në dy institucionet e kujdesit shëndetësor terciar në Tiranë (Qendra Kombëtare e Traumës në spitalin ushtarak dhe Materniteti "Mbreteresha Geraldinë") si dhe gjashtë qendra të tjera në spitalet rajonal (Kukës, Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë dhe Korçë). Ky projekt funksionon me tre komponentët kryesorë të tij- Asistenca mjekësore në distancë, Edukim i vazhdueshëm mjekësor në distancë, dhe bibliotekë elektronike.

Sistemi Informativ për Vaksinimin

Instituti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me Optimize kanë zhvilluar dhe pilotuar në Shkodër Sistemin Informativ për Vaksinimin (SIV). Ky është një sistem online që planifikon regjistrimin e imunizimit të fëmijëve dhe menaxhon stokun e vaksinave si dhe ruajtjen e tyre. Ky sistem pas pilotimit me sukses në Shkodër do të shtrihet në të gjithë Shqipërinë.

DRAFT

Sisteme të rëndësishme kompjuterike janë implementuar gjithashtu edhe nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), ku ndër më kryesorët përmendim:

- **Sistemin Elektronik për Recetat me Rimbursim,** i cili mban informacionin e recetave me rimbursim që ekzekutohen në farmacitë me kontratë me FSDKSH që i shërben për rimbursimin e farmacive për medikamentet e listës së barnave.
- **Sistemi Elektronik i Kostos së Spitaleve**, i cili mban informacionin e kartelave klinike të shtrimit të pacientëve në spitalet me kontratë me FSDKSH, si dhe informacion mbi shpenzimet e spitaleve për paga, shpenzime direkte dhe shpenzime të tjera indirekte.
- **Regjistri Elektronik i Depove Farmaceutike,** i cili mban informacion mbi faturat e furnizimit dhe atyre të shitjeve të Depove Importuese dhe atyre Distributore me kontratë me FSDKSH. Përmbajtja e këtij regjistri aksesohet nga Depot Farmaceutike me kontratë me FSDKSH të cilët kanë të instaluar sistemin. Në FSDKSH dërgohen kopje të informacionit për qëllime të brëndshme të monitorimit të aktivitetit të tyre në bazë kontrate me këto subjekte.
- **Sistemi Elektronik e-Farmaci,** i cili mban informacion mbi deklarimin e faturave të furnizimit dhe recetave me rimbursim të Farmacive me kontratë me FSDKSH. Përmbajtja e këtij regjistri aksesohet nga FSDKSH dhe Farmacitë me kontratë me FSDKSH sipas të drejtave specifike të përcaktuara në sistem.
- **Sistemi Elektronik i Depistimit,** i cili mban informacion mbi popullsinë që mbulohet nga mjekët e sistemit shëndetesor parësor të deklaruar nga këta mjekë. Përmbajtja e këtij regjistri aksesohet nga FSDKSH dhe Qendrat Shëndetësore sipas të drejtave të përcaktuara në sistem.

1.2.11 Sistemi i Punësimit

Në vitin 2013, ka përfunduar implementimi i sistemit informatik të Shërbimeve të Punësimit nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Ky sistem online është i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit në adresat www.puna.gov.al ose www.epunesim.gov.al**.** Sistemi është i implementuar në të gjitha zyrat rajonale te punësimit.

Ky sistem ofron:

- Për Punëdhënësit:

DRAFT

- Mundësinë të regjistrohen në sistem online,
- Të publikojnë një vend të ri pune,
- Të kërkojnë për profile (CV) punëkërkuesish,
- Të ftojnë punëkërkues për aplikim,

❖ Për Punëkërkuesit:

- Mundësinë të regjistrohen në sistem online,
- Të plotësojnë CV sipas formatit (Model i ngjashëm me atë të BE-së),
- Të kërkojnë për vende të lira pune,
- Të aplikojnë për punë;

1.2.12 DREJTËSIA (TIK)

1- Sistemi Elektronik "ICMIS", Integrated Case Management Information System

Sistemi elektronik ICMIS në funksion të administrimit, monitorimit, inspektimit në nivel makro apo analitik të indikatorëve që prodhon baza të dhënash kombëtare të arkivës së çështjeve gjyqësore. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar unifikimit të rekordit elektronik të çështjes gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit, e cila do të shkurtojë në maksimum kohën e proçedimit sipas niveleve të sistemit të drejtësisë, si dhe do të ofrojë mundësinë e ruajtjes së historikut të çështjes.

2- Sistemi elektronik i Regjistrimit Zanor në Sistemin Gjyqësor

Sistemi RDA (**Regjistrimi Dixhital Audio**), mundëson regjistrimin e të gjithë komunikimit verbal që ndodh gjatë seancave gjyqësore dhe siguron ridëgjimin e mëvonshëm të këtij komunikimi, sipas nevojës. Ajo ndihmon në mënyrë efikase procesin e një gjykimi të drejtë duke pasur parasysh krijimin e rekordeve të pandryshueshme audio, kjo teknologji ndikon në një sjellje me më shumë profesionalizëm dhe etike në sallën e gjyqit. Programi synon rritjen e transparencës, paanshmërisë dhe efektshmërisë në gjykata, konsolidimin e rolit mbikqyrës

DRAFT

dhe antikorrupsion të organizatave të shoqerisë civile dhe medias, si dhe forcimin e arsimimit juridik dhe avokatisë në Shqipëri.

3- Sistemi Elektronik "ALBIS", Albanian Bailiff's Information System

ALBIS është Sistemi i Manaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbarimit Gjyqësor. Si një sistem i centralizuar elektronik, mundëson akses të stafit përmbarimor shtetëror dhe privat në çdo moment dhe në kohë reale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

4- Sistemi Elektronik "RNSH", Regjistri Dixhital Noterial Shqiptar

Regjistri Dixhital Noterial është një sistem elektronik që mundëson regjistrimin e akteve dhe veprimtarive noteriale nga noterët në një sistem kombëtar qendror. Ky regjister është tashmë online 24 orë në 24, dhe në çdo moment mund të kryen veprime dhe të merret informacion.

5- Sistemi i Mbikqyrjes Elektronike "EMs" (Electonic Monitoring System)

Ministria e Drejtësisë pas konsultimeve me ekspertë të fushës dhe pas analizës së praktikave më të mira europiane, adaptoi si zgjidhje të problemeve të mbikëqyrjes së vendimeve gjyqësore që kufizojnë lirinë e lëvizjes, Mbikqyrjen Elektronike ME *(Electronic Monitoring EM*) të personave të cilëve me vendim gjyqësor u kufizohet lëvizja.

6- Aplikimi web, Ankimi On Line (iniciativa e MD, STOP KORRUPSIONIT)

Ky portal ka një rëndësi të jashtëzakonshme për konsolidimin e drejtësisë, monitorimin e publikut ndaj gjyqësorit dhe krijon një hapsirë të re të shprehjes së qytetarëv

1.2.13 PËRGATITJA E QEVERISË VENDORE PËR E–QEVERISJE

Qeveria Vendore po kupton çdo ditë e më shumë nevojën për t'i afruar shërbimet tek qytetarët, bizneset, vizitorët e partnerët. Përdorimi i TIK ka gjetur hapësirë në përmirësimin e

proceseve administrative, lehtësimin e qasjes ndaj informacionit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve në një numër fushash të veprimtarisë së pushtetit vendor të tilla si taksat, buxhetet, planifikimi dhe menaxhimi i territorit, inspektimi, emergjencat, përfshirja e qytetarëve e bizneseve në vendimarrje deri në modelet më te avancuara të ngritjes së Zyrave me Një Ndalesë, etj.

Pavarësisht përpjekjeve dhe arritjeve në pak raste dokumentet strategjike të QV citojnë objektiva, programe dhe projekte për e–QV (p.sh, Lezha[6]), gjë që dëshmon për mungesën e një vizioni afatgjatë në fushën e e-Qeverisjes. Prania ende e kufizuar e NJQV-e në web sipas standarteve të aprovuara nga AKSHI është shenjë e një stadi të ulët zhvillimi të sektorit.

Në kuadër të zbatimit të reformës administrative-territoriale dhe përshtatjes së kornizës ligjore, QV-të do të duhet të organizohen dhe funksionojnë në një mjedis administrativ dhe terriorial shumë më të gjerë. Në këto kushte NJQV-të e reja do përballen me sfidën e ri-organizimit të brendshëm dhe bashkëpunimit me Qeverinë për nivelin e integrimit në sisteme të interoperabilitetit për shërbimet e ofruara nga qeveria qendrore, që përkojnë me funksionet e deleguara apo të përbashkëta. Riorganizimi do t'i transformojë një pjesë të NJQV në njësi administrative me një ndalesë. Krijimi dhe funksionimi i një infrastrukture të integruar të Zyrave me 1 Ndalesë (one stop shops) që ofrojnë e-shërbime për qytetarët, bizneset apo vizitorët, si dhe mundësimia i bashkëveprimit me Qendrën e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara (ADISA) do jenë drejtimet kryesore ku do mbështet stragjia për zhvillimin e e-QV-së.

[6] Plani Strategjik i Bashkisë Lezhë, 2013-2030

2 VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET E POLITIKAVE

2.1 VIZIONI

Vizioni Një shoqëri e bazuar në dije dhe informacion për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social, konsolidimit të infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar me rigorozitet parimet evropiane të konkurrencës së lirë e të ndershëm, .duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike dhe duke rritur transparencën e qeverisjes

2.2 Qëllimi i Strategjisë

Qëllimi i "Strategjisë Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2014-2020" është përcaktimi i parametrave, veprimeve kyçe, institucioneve përgjegjëse, afateve kohore, buxhetit, për zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit në Shqipëri, si dhe mbështetjen për zhvillimin e udhëzimeve të BE dhe detyrat e përcaktuara nga Axhenda Dixhitale e Evropës, duke marrë parasysh potencialin social dhe ekonomik të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe Internetit deri më 2020.

Shqipëria në rrugën e saj drejt antarësimit në Bashkimin Evropian duhet të zhvillojë objektiva strategjike kombëtare që janë në përputhje me prioritetet dhe qëllimet strategjike të BE-së, implementimi i të cilave do të çoj në përmbushjen e tyre.

Kjo strategji bazohet në supozimin se secili autoritet është përgjegjës për implementimin financiar dhe administrativ të masave të përcaktuara në këtë strategji, për implementimin me sukses të të cilëve do të përcaktohen projekte individuale të financuara si nga buxheti i shtetit, nga fondet e Bashkimit Evropian, Institucionet e ndryshme ndërkombëtare, etj .

Qëllimi i kësaj strategjie është që Shqipëria të arrij të jetë në nivele konkurruese në fushën e Teknologjive të Informimit e të Komunikimit në rajon e më gjerë. Plani i veprimeve i kësaj strategjie së bashku me indikatorët përkatës do të shërbëjnë për krijimin e një baze për matjen e vazhdueshme të arritjeve të TIK në vendin tonë.

Plani i veprimeve në vetvete do të rishikohet përsëri për periudhën 2017-2020 për të qënë më gjithëpërfshirës, realistë dhe për të indentifikuar problematikën gjatë implementimit të tyre.

DRAFT

Aktualisht, shumë nga Indikatorët e vendosur në këtë strategji, nuk maten nga institucionet e ndryshme të vendit tonë, si pasojë e problematikave me të cilat përballet pjesa politikbërëse dhe ajo vendimmarrëse për këtë sektor kaq të veçantë për zhvillimin modern të shoqërisë shqiptare. Matja e këtyre indikatorëve, në të ardhmen, do të krijojë një imazh më të plotë e të qartë të zhvillimit të sektorit si dhe do të ndihmojë në orientimin e duhur drejt sfidave me të cilat përballet jo vetëm Qeveria por e gjithë shoqëria shqiptare në përdorimin e Teknologjive të Informacionit e të Komunikimit, si në punë dhe në jetën e tyre të përditëshme.

2.3 DREJTIMET KRYESORE

Strategjia Ndërsektoriale "Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2014-2020" përcakton objektivat që duam të arrijmë dhe përcakton politikat për permbushjen e këtyre objektivave duke u fokusuar në problematikat dhe prioritetet që duhen adresuar. Këto janë në përputhje me SKZHI 2014-2020 dhe përfshijnë në vetvete edhe trendin e Axhendës Evropiane 2020. Fushat kryesore orientohen drejt aplikimit dhe implementimit të Teknologjive të Informacionit e të Komunikimit si dhe Internetit, të cilat priten të çojnë në eko-sisteme inovative:

- Zhvillimi i infrastrukturës së përparuar të komunikimeve elektronike;
- Sigurimin e spektrit të mjaftueshëm për zhvillimet në prespektivën e infrastrukturës Broadband (NGN/LTE/5G etj);
- Ofrimin e shërbimeve elektronike eficente për të arritur kushtet optimale për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zhvillimit ekonomik dhe social të vendit;
- Forcimi i arsimit modern dhe zhvillimi i sektorit të kërkimit dhe zhvillimit, bazuar në shpikjet më të fundit teknologjike;
- Krijimi dhe promovimi i mjediseve të favorshme për biznesin për sipërmarrjen inovative me qëllim krijimin e një ekonomie konkurruese;
- Krijimin e një Sistemi Informacioni Gjeohapësinor Kombëtar dhe Kadastrës Multifunksionale;
- Adresimin e problemeve me Big Data, mbrojtjen e të dhënave personale në "cloud";
- Mbrojtjen e IPR në fushën e internetit;
- Promovimin e e-Commerce;
- Promovimi i e-Zyrave me një ndalesë për qeverisjen vendore;

DRAFT

3 OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

Kjo strategji do të ketë si motor kryesor të nxitjes së saj Ofrimin e Shërbimeve ndaj Qytetarëve, Bizneseve dhe Reformën në Administratën Publike. Ndër të tjera ajo do të bazohet në parimet e mëposhtme të cilat përcaktojnë procesin e zhvillimit të Shoqërisë së Informacionit në Shqipëri:

- ✓ **Njerëzit janë të parët**. Përshtatshmëria e çdo programi, projekti dhe veprimtarie në ndërtimin e Shoqërisë së Informacionit duhet të matet nga inputet dhe përfitimet e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë si përdorues të tyre. Çdo program, projekt dhe veprimtari duhet të respektojë të drejtat e qytetarëve, duke përfshirë edhe të drejtën e privacisë.
- ✓ **Fuqizimi individual**: Shoqëria demokratike do të përqafojë dhe të përgjigjet për problemet kolektive dhe individuale të njerëzve që shprehen me anë të platformave dixhitale. Fuqizimi individual është në thelbin e fuqisë transformuese të teknologjive dixhitale në të gjithë ekonominë tonë dhe të shoqërisë. Me rritjen e fuqisë së teknologjive dixhitale rritet edhe fuqizimi individual.
- ✓ **Aksesi në shërbimet e ofruara nga Qeveria dhe ndihma në krijimin e Start Up-et.** Duke marrë parasysh natyrën sociale të Shoqërisë së Informacionit, Qeveria do të investojë në veprimtari dhe shërbime që synojnë zbutjen e varfërisë, në zona të caktuara, të cilat mund të kenë potencial të madh ekonomik dhe social në të ardhmen. Ato shërbime, ide, koncepte që dëshmojnë mundësi të pastra biznesi do të orientohen në përputhje me fushat përkatëse të biznesit.
- ✓ **Përputhje e plotë me Politikat e Bashkimit Evropian.** Ndërtimi i Shoqërisë së Informacionit në Shqipëri duhet të jetë në përputhje me *aquis* e Bashkimit Evropian. Gjithashtu duhet të jetë në përputhje me politikat e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU), Këshillit të Evropës si dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, duke marrë parasysh nivelin e zhvillimit kombëtar dhe gjendjen e vendit.
- ✓ **Integrimi kombëtar i burimeve TIK.** Përmirësimi i eficensës së investimeve publike në TIK bazuar në integrimin e të dhënave për përshtatshmëri të plotë midis sistemeve.
- ✓ **Bashkëpunimi ndërkufitar, rajonal e më tej.** Ky bashkëpunim do të përqëndrohet në disa fusha si: Kërkimi dhe Inovacioni; Teknologji Informacioni dhe Komunikimi; Konkurueshmëria e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme; Përfshirja sociale;

DRAFT

- ✓ **Bashkëpunim Qeveri Qendrore – Qeveri Vendore (3QV).** Qeveria do të ndërtojë politika mbështetëse dhe rregullatore për dixhitalizimin e shërbimeve të cilat janë pjesë e paketës së funksioneve të qeverisë vendore dhe do të koordinojë interoperabilitetin për e-shërbimet e përbashkëta dhe të deleguara.
- ✓ **Besimi dhe Siguria e rrjeteve dhe informacionit.** Qeveria do të vërë në zbatim një sistem normash, sanksionesh dhe burimesh për të garantuar sigurinë e të dhënave dhe sistemeve TIK. Të gjitha përpjekjet e ndërmarra në fushën e Shoqërisë së Informacionit duhet të ndjekin parimet e pranuara dhe standardet e sigurisë për të mos krijuar kushte shtesë që mund të kompromentojnë ose cënojnë të dhënat personale ose të palëve të treta. Këto përfshijnë identifikimin dhe autentifikimin, mbrojtjen e të dhënave, mbrojtjen nga krimi kibernetik, mbrojtjen e të dhënave intelektuale, mbrojtjen e konsumatorit, etj.
- ✓ **Efektiviteti dhe eficensa.** Zhvillimi i Shoqërisë së Informacionit duhet të implementohet nëpërmjet projekteve të cilat mbështesin qëllimet dhe prioritetet e politikave shtetërore, të përcaktuara në strategjitë në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor nëpërmjet përdorimit më efikas dhe eficent të burimeve të kufizuara.
- ✓ **Cilësia e përmbajtjes dixhitale**. Çdo veprimtari, projekt ose iniciativë, që çon në krijimin e përmbajtjes dixhitale, veçanërisht ato që kanë karakter kombëtar, do të mbështeten dhe strukturohen si pjesë e sistemit të trashëgimisë kombëtare dixhitale.
- ✓ **Bashkëpunim - Partneritet Publik Privat (PPP).** Në veprimtaritë e saj, Qeveria do të bazohet në dijen, aftësitë dhe fleksibilitetin e bizneseve, universiteteve dhe Organizatave Jofitim Prurëse dhe Jo qeveritare të TIK në Shqipëri, për një zhvillim eficent të Shoqërisë së Informacionit në Shqipëri.
- ✓ **Neutraliteti Teknologjik**. Parimi i neutralitetit teknologjik në veprimtaritë rregullatore të lidhura me zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit, me qëllim mbrojtjen e interesit të qytetarëve dhe konsumatorëve.

Strategjia synon koordinimin dhe ndërveprimin e të gjithë palëve nëpërmjet të cilit zhvillimi i Shoqërisë së Informacionit në Shqipëri nuk shikohet si detyrë ose qëllim i një departamenti apo njësie administrative, por si një objektiv i përbashkët i të gjithë aktorëve, si sektori publik, bota akademike, OJQ-të, shoqëria civile dhe organizatat private.

Duke marrë në konsideratë veprimet që duhet të ndjek Administrata Publike lidhur me "rritjen dixhitale", prioritetet kryesore mund të përmblidhen në tabelën që vijon:

DRAFT

	ADMINISTRATA PUBLIKE	RRITJA DIXHITALE
TIK SI FAKTOR NXITËS	Administratë e hapur Komunitete inteligjente e-Leadership brenda Administratës Publike	Tregu Dixhital Inovacioni social e-Leadership për ndërmarrjet
TIK SI POLITIKË SEKTORIALE	Administratë dixhitale (shërbime publike të unifikuara & switch-off, e-shërbimet Rritja e kapaciteteve brenda Administratës Publike për programe & projekte TIK	TIK si KET për Kërkimin Shkencor & Inovacionin Mbështetje ndaj ndërmarrjeve Aftësitë Dixhitale
TIK SI INFRASTRUKTURË	Data center dhe Cloud SPC dhe Siguria CERT-PA	Internet me brez të gjerë

Tabela 10 Infrastruktura dhe siguria, e-Commerce (tregtia elektronike), e-Government dhe Open Data, Aftësi Dixhitale, Kërkim & Inovacion, Qytete & Komunitete Smart.

Sektorët e tjerë që paraqesin një prioritet përsa i përket procesit të dixhitalizimit dhe inovacionit në kuadrin "smart" janë:

- Shkolla - shkolla dixhitale dhe inovacioni në mësim-dhënie
- Drejtësia - proceset telematike dhe inovacionin e menaxhimit të proceseve

DRAFT

- Kultura dhe turizmi - dixhitalizimi i trashëgimisë kulturore dhe inovacioni e proceseve të promovimit
- Energjia - rrjete dhe ndërtesa smart
- Mjedisi.
- Shëndetësia

Vëmendje e vëçantë i duhet përkushtuar Shëndetit dixhital (e-Health), e cila është përcaktuar në nivel evropian si një nga sfidat kryesore sociale. Për këtë duhet patur parasysh jo vetëm raporti midis pacientit dhe strukturave mjekësore (si Kartela mjekësore elektronike" dhe ndërhyrje të tjera interoperabiliteti të shërbimeve të lidhura me e-Health) por edhe mundësia e komunikimit të drejtpërdrejtë midis pacientit dhe mjekut, pajisje që vishen dhe aplikacione që ndikojnë mënyrën e të jetuarit, instrumentet e telemjekësisë dhe teleasistencës, etj.

Promovimi i **komuniteteve inteligjente, faturimit elektronik dhe identitetit dixhital** janë të rëndësishme për krijimin dhe nxitjen e një shoqërie informacioni.

Objektivat e Strategjisë, zbatimi i të cilave do të sigurojnë plotësimin e Drejtimeve të përmendura më lart duhet të përputhen plotësisht me fushat e veprimit dhe objektivat e Agjendës Dixhitale 2020 për Evropën; objektivat janë vendosur në përputhje me specifikat e mjedisit të biznesit, si dhe kuadrin ekonomik në Shqipëri:

- Ndërveprimin dhe inkurajimin e përdorimit më të mirë të sistemeve;
- Rritja e besimit në TIK nëpërmjet forcimit të politikës së sigurisë për rrjetet dhe informacionin;
- Sigurimi i lidhjes me internet të shpejtë në të gjithë vendin;
- Tejkalimi i hendekut dixhital duke rritur arsimimin dixhital dhe aftësitë për përdorimin e TIK-ut;
- Realizimi i qytetarisë dixhitale. Kjo do të thotë identifikim dhe përcaktim të të drejtave dhe detyrimeve të qytetarëve në kuadër të shoqërisë së dijes dhe krijimi i kushteve të favorshme për pjesëmarrjen e tyre në proceset e dixhitalizimit;
- Realizimi i përfshirjes dixhitale. Kjo do të thotë krijimi i kushteve të barazisë së mundësive në përdorimin e rrjeteve dhe për zhvillimin e kulturës së inovacionit dhe krijueshmërisë, duke shmangur çdo formë deformimi dhe fshehje të informacionit dhe zgjidhjeve, me qëllim uljen e diskriminimit social dhe kulturor dhe hapjen e dyerve

DRAFT

ndaj përfitimeve që vijnë nga Shoqëritë e Dijes, si të mësuarit cilësor gjatë gjithë jetës;

- Zhvillimin e politikave për krijimin e dijes dixhitale nëpërmjet përfshirjes sociale, rritja e aksesit të personave me aftësi të kufizuara ndaj teknologjive dhe shërbimeve TIK, me qëllim promovimin e kërkimit shkencor dhe përdorimit të teknologjisë për asistencë ndaj personave me aftësi të kufizuar;
- Promovimi i një vetëdije dhe besimi më të madh lidhur me dixhitalizimin dhe sigurinë e tij për të ulur "hendekun dixhital", duke përfshirë në mënyrë aktive universin femëror, veçanërisht në fushën e sipërmarrjes me qëllim rritjen e fuqisë punëtore femërore në kuadër të TIK;
- Promovimin e modeleve të mësim nxënies për të moshuarit duke përfshirë studentët, persona me njohuri dhe dije teknologjike, të cilët shërbejnë si tutor për të rriturit dhe të moshuarit;
- Implementimin e politikave kombëtare që favorizojnë dhe mbështesin metodologjitë e të mësuarit në distancë (p.sh. es. e-learning, mooc, ëebinar, përdorimin e instrumenteve dhe faqeve sociale për sensibilizimin dhe arsimimin);
- Promovimin e përdorimit të TIK në sektorë të ndryshëm profesional si në atë publik dhe privat për të garantuar formimin profesional të vazhdueshëm, duke shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga e-learning;
- Përcaktimin e profesioneve të reja TIK (si dhe të aftësive dhe përmbajtjes formuese që lidhen me to) që janë duke u përcaktuar në treg, duke ju referuar kuadrit rregullator evropian me qëllim garantimin e njohjes së profileve profesionale TIK në kontratat e punës, tenderat, përputhjen e kërkesës me ofertën për afësitë TIK në tregun e punës.
- Rritja e përpjekjeve për përmirësimin e efektivitetit të veprimtarive kërkimore dhe inovative dhe nxitjen e inovacionit në fushën e TIK;
- Rritja e përfitimeve të TIK për shoqërinë duke rritur rëndësinë e tyre për mbrojtjen mjedisore për të siguruar shëndet të qendrueshëm;
- Rritja e përfitimeve të TIK duke promovuar diversitetin kulturor dhe krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes dixhitale;
- Nxitja e përdorimit të përmbajtjes dixhitale për zhvillimin e qeverisjes elektronike;
- Ndërtimi i sistemeve inteligjente të transportit për të përmirësuar lëvizjen e qytetarëve;

DRAFT

- Aspektet ndërkombëtare të Strategjisë Ndërsektoriale – promovimi i sektorit TIK në Shqipëri si dhe forcimi i bashkëpunimit në nivel global me qëllim zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të të rinjve, studentëve dhe profesorëve shqiptarë në fushën e TIK.

4 PROGRAMI I INVESTIMEVE NË FUSHËN E TEKNOLOGJIVE TË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Programi i ri i investimeve në TIK i Qeverisë shqiptare synon drejtimin më të koordinuar dhe më efikas të investimeve në këtë sektor me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarin. Kjo qasje e re do të rrisë mundësitë për rritjen e performancës së punës së Qeverisë si pasojë e përpjekjeve të përbashkëta për zgjidhje më të qendrueshme, afatgjata dhe të sigurta. Ndërsa Ministritë e linjës, drejtoritë e përgjithshme dhe agjencitë kombëtare janë përgjegjëse për investimet e tyre në fushën e TIK, qëllimi është koordinimi i punës dhe bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të fushës për zgjidhjen e problemeve dhe ofrimin e shërbimeve.

Ky qëllim përcakton dy përgjegjësi kryesore për Bordin TIK të Qeverisë:

- Vendosjen dhe monitorimin e pajtueshmërisë së parimeve të investimit të Qeverisë në TIK, për të mbështetur implementimin e investimeve TIK për një qasje të qëndrueshme, të përbashkët dhe të standardizuar.
- Për t'u siguruar që këto investime të mbështesin plotësimin efektiv dhe efikas të objektivave të TIK të Qeverisë shqiptare.

Komponentët e Programit:

Duke u nisur nga qëllimi i mësipërm, të gjitha vendimet për investimet Qeveritare në TIK duhet të jenë në përputhje me programin e Qeverisë dhe të shërbejnë si një mjet i sofistikuar për aplikimin e prioriteteve të Qeverisë Shqiptare sipas programit:

a) Përmirësimi i shërbimeve ndaj publikut;

b) Përmirësimi i efiçencës së Qeverisë në administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve;

c) Ndihma e sistemeve TIK në aplikimin me sukses të reformës administrative, reformës territoriale dhe asaj në drejtësi;

DRAFT

d) Ritja e efiçencës së sektorit prodhues, Bujqësi, Turizëm dhe Industri nëpërmjet sistemeve të TIK;

e) Administrimi dhe standardizimi i bazës së të dhënave shtetërore si një mjet ndihmës në mirëfunksionimin dhe administrimin e informacionit në shërbim të rritjes së shërbimeve ndaj biznesit dhe qytetarit;

f) Rritja e kapaciteteve njerëzore duke filluar përdorimin e teknologjive të reja nga sistemi parashkollor deri në administratën publike dhe drejtuesit e lartë;

g) Rritja e performancës dhe efiçencës së pushtetit lokal nëpërmjet përdorimit të sistemeve dhe metodologjive të reja nëpërmjet TIK;

h) Rritja e transparencës në shërbim të komunikimit me publikun dhe luftës kundër korrupsionit;

a) Përmirësimi i shërbimeve ndaj publikut;

Në përmirësimin e shërbimeve ndaj publikut përfshihen krijimi i sistemeve back-office dhe front-office për ofrimin e shërbimeve, marrjes së dokumentave që lëshohen nga shteti shqiptar në nivel qendror dhe lokal, aplikimeve dhe deklarimeve, veprimeve financiare, etj., duke patur si qëllim ofrimin e këtyre shërbimeve në qendra unike.

b) Përmirësimi i efiçencës së Qeverisë në administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve;

Në këtë drejtim synohet përmirësimi i sistemeve ekzistues dhe krijimi i sistemeve të reja TIK që përfshijnë sistemin e tatim taksave, doganave, manaxhimit të kontratave dhe koncesioneve, shërbimet e përkrahjes sociale dhe atyre me aftësi të kufizuar, administrimit dhe manaxhimit të pasurive shtetërore, administrimit të shpenzimeve në bujqësi, në shëndetësi, në arsim,në drejtësi, në pushtetin lokal etj.

c) Ndihma e sistemeve TIK në aplikimin me sukses të reformës administrative, reformës territoriale dhe asaj në drejtësi;

Implementimi i reformave të mëdha të ndërrmara nga Qeveria shqiptare si reforma territoriale, reforma administrative dhe ajo në drejtësi kërkojnë patjetër një mbështetje në sistemet TIK si elementë ndihmës në realizimin e këtyre reformave. Duke u nisur nga ky qëllim synohet ngritja dhe funksionimi i sistemit të adresave dhe lidhja me regjistrin kombëtar të popullsisë, sisteme TIK që ndihmojnë në rritjen e performancës së pushtetit lokal, në sistemet e reja TIK në shërbim të gjykatave, noterisë dhe përmbarimit, regjistrimit të pronave, manaxhimit me efikasitet të sistemit të burgjeve, ngritjes së nivelit të administratës qendrore dhe lokale etj.

DRAFT

d) Ritja e eficencës së sektorit prodhues, Bujqësi, Turizëm dhe Industri nëpërmjet sistemeve të TIK;

Me anë të kësaj pjese të programit synohet modernizimi i sektorëve prodhues të vendit nepërmjet TIK, mundësimi i plotësimit të standardeve dhe kualitetit të produkteve dhe shërbimeve në përputhje me direktivat e Komunitetit Europian në mënyrë që të rriten eksportet e produkteve bujqësore dhe blegtorale, ushqimore dhe minerare si dhe të transferimit të teknologjive.

e) Administrimi dhe standardizimi i bazës së të dhënave shtetërore si një mjet ndihmës në mirëfunksionimin dhe administrimin e informacionit në shërbim të rritjes së shërbimeve ndaj biznesit dhe qytetarit;

Kjo pjesë e programit do të kujdeset për konsolidimin e bazave të të dhënave ekzistuese dhe ndërtimit të databazave të reja shtetërore, ndërveprimit ndërmjet tyre, ndërmjetësimit me sistemet online të të dhenave dhe aplikimeve ku do të kemi parasysh që si bazë për ngritjen dhe konsolidimin e këtyre bazave të të dhënave do të shërbejë numri unik identifikues për personat dhe bizneset.

f) Rritja e kapaciteteve njerëzore duke filluar përdorimin e teknologjive të reja nga sistemi parashkollor deri në administratën publike dhe drejtuesit e lartë;

Shoqëria shqiptare duhet të jetë e përgatitur për sfidat e reja të cilat pa përvetësimin e teknologjive të informacionit. Gjithashtu çdo sistem TIK ekzistues apo që do të ndërtohet nuk mund të vihet në efiçencë pa ndihmën e burimeve njerëzore të cilat duhet të parapërgatiten për përdorimin e tyre. Prandaj del e nevojshme që të aplikohen programe të edukimit në TIK të cilat do të fillojnë që nga arsimi parashkollor, cikli i ulët arsimor, shkollat e mesme dhe të larta, arsimi profesional deri tek ngritja e nivelit të njohurive në TIK për nëpunësit e administratës qendrore dhe asaj lokale në të gjitha nivelet.

g) Rritja e performancës dhe efiçencës së pushtetit lokal nëpërmjet përdorimit të sistemeve dhe metodologjive të reja nëpërmjet TIK;

Qëllimi i Qeverisë shqiptarë është të vendosi një marrëdhënie korrekte midis administratës qendrore dhe lokale dhe publikut duke e trajtuar sipas konceptit Customer Care (klient) të shërbimeve qeveritare. Në këtë kuptim përmirësimi dhe konsolidimi i përdorimit të TIK në administratën qendrore nuk mund të veçohet nga përdorimi i TIK në administraten lokale e cila është përgjegjëse në një pjesë shumë të mirë të shërbimeve ndaj publikut.

h) Rritja e transparencës me publikun në shërbim të komunikimit me publikun dhe luftës kundër korrupsionit;

DRAFT

Kjo pjesë e programit do të bëjë të mundur krijimin e besimit të publikut ndaj Qeverisë dukë qënë vazhdimisht i informuar për të ardhurat dhe shpenzimet qeveritare, mënyrën e rekrutimit dhe funksionimit të administratës shtetërore, detyrimeve dhe angazhimeve të Qeverisë, legjislacionit ekzisues dhe nismat për ligjet, vendimet dhe urdhërat, angazhimet ndërkombëtare etj. Gjithashtu kjo pjesë e programit do të shërbejë për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga nisma për një partneritet të hapur (OGP).

DRAFT

5 PLANI I VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E STRATEGJISË AXHENDA DIXHITALE E SHQIPËRISË 2014-2020

Plani i Veprimit do të përcaktojë masat specifike që lidhen me zhvillimin dhe përhapjen e TIK, të cilat do të grupohen sipas prioriteteve që vijojnë:

- ✓ Zhvillimi i e-Qeverisjes;
- ✓ Zhvillimi i e-Shëndetësisë;
- ✓ Zhvillimi i internetit me brez të gjerë (Broadband);
- ✓ Promovimi i investimeve për krijimin e punëve të reja në industrinë e teknologjisë së lartë dhe shërbimet e bazuara në dije (arsim, kërkim dhe zhvillim, TIK, etj);
- ✓ Krijimi i sistemit qëndror të informacionit gjeohapësinor;
- ✓ TIK për eficensën në energji;
- ✓ TIK për përmirësimin e Sistemit Arsimor;

5.1 PRESPEKTIVA E E-GOVERNMENT 2014-2020

Zhvillimet për e-Qeverisjen do udhëhiqen nga parimet për një qeverisje të mirë, transparente, duke nxitur një kulturë bashkëpunimi dhe duke synuar një administratë të hapur, fleksibël dhe bashkëpunuese me qytetarët dhe biznesin. Shqipëria si vend kandidat do të ndjekë praktikat e BE-së për e-Qeverisjen dhe do implementojë deklaratën e ministrave për e-Qeverisjen.

Programi i qeverisë 2013-2017 e trajton TIK dhe e-sherbimet të lidhura ngushtë me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Në programin e qeverisë është përcaktuar se, do të punohet në dy drejtime kryesore duke vendosur objektiva të matshëm dhe të arritshme:

- Së pari, për shtimin dhe promovimin e shërbimeve elektronike, e-shërbimeve, për qytetarët dhe biznesin. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike sipas parimeve të iniciativës "Open Government Partnership";
- Së dyti, konsolidimi i infrastrukturës dixhitale në Administratën Publike;

Përmes "Government Gateëay", AKSHI do të realizojë ndërlidhjen dhe komunikimin e të gjitha sistemeve të informacionit në mënyrë që këto sisteme të ndërlidhura të komunikojnë

DRAFT

me njëra tjetrën, të shkëmbejnë informacion duke mënjanuar praktikat e sistemeve të shkëputura dhe veçanërisht dublikimin e të dhënave.

Nëpërmjet integrimit të të gjitha sistemeve IT dhe shërbimeve elektronike, me realizimin në praktikë të ndërveprimit "connected IT systems" dhe "e-Services" do të kemi:

- rritje të numrit të shërbimeve tërësisht elektronike;
- kalimin në mënyra të reja të ofrimit të shërbimeve publike si mobile shërbime;
- përmirësimin e shërbimeve për qytetarin dhe biznesin përmes ofrimit të tyre në portalin unik qeveritar.

Zbatimi i kuadrit të ndërveprimit dhe "*Government Gateëay*" do t'i shërbejë jo vetëm zhvillimit të shërbimeve elektronike, lehtësimit të praktikave për qytetarët dhe biznesin me administratën publike, por në mënyrë të veçantë kjo i shërben, përmbushjes së objektivave madhore të qeverisë në:

- luftën kundër korrupsionit, duke reduktuar burokracinë në administratën publike;
- luftën kundër ekonomisë informale;
- rritjes së efikasitetit, efektivitetit dhe transparencës së qeverisjes, duke u bazuar në parimet e iniciativës së një qeverisje të hapur;
- rritjes së pjesëmarrjes qytetareve në qeverisjes dhe vendimmarrje, etj.

Në nivel kombëtar, zhvillimet në qeverisjen elektronike do synojnë rritjen e eficencës dhe efektivitetit për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme shërbimet publike përmes:

- Projektimit të shërbimeve sipas nevojave të qytetarëve dhe sigurimi i shpërndarjes së tyre në rrugën me efektive;
- Kooperimit mes sektorit publik e privat si dhe me palë të treta për zhvillimin innovator fleksibël të shërbimeve të personalizuara;
- Rritjes së informacionit publik të disponueshëm për ripërdorim;
- Forcimit të transparencës në proceset administrative;
- Përfshirjes së grupeve të interesit në proceset e politikëbërjes;

DRAFT

- Zhvillimit të shërbimeve cross-border;

Zbatimit të standarteve të TIK-ut për realizimin e ndërveprimit të sistemeve dhe shërbimeve;

5.1.1 Lidhja e sistemeve IT me ESB- realizimi i plotë i ndërveprimit

Kërkesa për ndërveprim përtej planit kombëtar, por edhe në nivel BE del sot si nevojë në shumë sektorë si psh në fushën e shëndetësisë, në atë të ofrimit të shërbimeve ndërkufitare, në prokurimin publik, në fushën e edukimit etj. Në të gjitha këto procese shtrohet i domosdoshëm kooperimi në të gjitha nivelet e realizimit të ndërveprimit:

- në nivel teknik
- në nivel semantik
- në nivel organizativ
- në nivel ligjor

Lidhja e sistemeve IT me ESB dhe realizimi i plotë i ndërveprimit të sistemeve IT është me rëndësi strategjike ajo bën të mundur kalimin nga sisteme/investime të copëzuara të fragmentuara në krijimin e një sistemi plotësisht të integruar sipas standarteve ndërkombëtare. Kjo do të evitojë shpenzimet e panevojshme dhe të tepërta, që do të duheshin për të krijuar infrastruktura të veçanta, por edhe efikasitet operacional.

5.1.2 Një shoqëri informacioni e sigurtë

Infrastruktura kritike e teknologjisë së informacionit në nivel kombëtar përfshin:

1. Qendrën e të dhënave qeveritare;
2. Qendrën e Vazhdueshmërisë së Funksionimit (Business Continuity Center - BCC);
3. Qendrën e Rikuperimit nga Fatkeqësia (Disaster Recovery Center - DRC);
4. Rrjetin qeveritar Gov-NET;
5. Bazat e të dhënave shtetërore të rëndësisë së veçantë.

DRAFT

Fuqizimi dhe mbrojtja e Infrastrukturës Kritike dhe Objekteve të rëndësisë së veçantë, të teknologjisë së informacionit. Për të garantuar një shoqëri informacioni të sigurtë dhe shërbime e-Qeverisjes të besueshme dhe të sigurta do të punohet për krijimin dhe konsolidimin e qendrave BCC, DRC, rritjen e sigurisë së GovNET, zbatimin e kërkesave të larta teknike për bazat e të dhënave shtetërore etj.

5.2 Inovacioni dhe Zhvillimi i Teknologjisë për SME-të.

Shqipëria ka regjistruar një rritje të shpejtë në numrin e sipërmarrjeve, një fakt që tregon një shkallë të lartë të dëshirës për sipërmarrjen në vend. Me mbështetjen e projektit IPA 2007 "Mbështetja e SME-ve për tu bërë më konkurruese në tregun Europian", është hartuar strategjia e Inovacionit dhe teknologjisë së biznesit. Për të konkretizuar zbatimin e kësaj strategjie, me VKM Nr. 104, datë 9.2.2011 u miratua Programi Strategjik për Zhvillimin e Inovacionit dhe Teknologjisë për SME-të. Ndërmjet metodave kryesore që përdoren në Shqipëri për inovacionin janë: Blerja e makinerive dhe pajisjeve dhe rekrutimi i personelit të kualifikuar.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në kapacitetin e firmave për të thithur teknologjinë e re janë: *klima e investimit* në të cilën ato operojnë dhe *niveli i aftësive* dhe i kapaciteteve teknologjike në firma. Në Shqipëri vetëm 10 % e të gjitha firmave të vëzhguara u japin trajnime formale punonjësve të tyre, krahasuar me 79 % të firmave Sllovake të përfshira në studim në 2005 dhe 48 % të firmave në Serbi *(Banka Botërore, 2009, fq. 48).*

Zhvillimi i infrastrukturës së SME-ve. Është e nevojshme krijimi i inkubatorëve për start up. Këto inkubatorë duhet të ofrojnë hapësira fizike si dhe të japin shërbime në mbështetje të bizneseve. Është e nevojshme krijimi i klasterave në sektorët kyç duke mbështetur platformat e bashkëpunimit. Bashkëpunimi strategjik midis ndërmarrjeve të ndryshme dhe nxitja e shërbimeve të përbashkëta dhen krijimi i zinxhirit të vlerave do të sjellin internacionalizimin e SME-të dhe akses në tregje të reja.

Përmirësimi i shërbimit ndaj biznesit. Ka një rëndësi të veçantë përmirësimi dhe rritja e shërbimeve ndaj biznesit nëpërmjet kompletimit dhe fuqizimit të portalit për SME-të ashtu si dhe qendrës së informacionit për biznesin; realizimin e nevojave për trajnime, TNA, çdo dy

DRAFT

vjet; përmirësimi i shërbimit on line për trajnimet; menaxhimi i skemave financiare për ndarjen e kostove, etj.

5.2.1 Nxitja e konkurrueshmërisë së SME-ve dhe inovacioni

Konkurrueshmëria e bizneseve shqiptare është përmirësuar nga vitit në vit, por si objektiv i rëndësishëm për periudhën 2014-2020 mbetet :

Rritja e mëtejshme e konkurueshmërisë së ekonomisë duke përmirësuar vlerësimin nga 4.06 pikë në vitin 2012 në 4.5 pikë në vitin 2020 (sipas raportit të GCI).

Synohet që për periudhën 2014-2016, do të zbatohet Programi Strategjik për Zhvillimin e Inovacionit dhe Teknologjisë të SME-ve për periudhën 2011-2016 miratuar me Vendimin Nr. 104, datë 09.02.2011 të Këshillit të Ministrave.

Objektivi kryesor i zhvillimit të programit strategjik është:

5.2.2 Rritja e aftësisë së bizneseve shqiptare për të zhvilluar, përdorur, përshtatur dhe komercializuar teknologjinë.

Kjo do të arrihet nëpërmjet mbështetjes me instrumentet financiare të përshtatshme të orientuar drejt zhvillimit të produkteve të reja dhe stimulimit të SME-ve për të përdorur dhe përshtatur teknologji të reja. Kjo do të kontribuonte në përmirësimin e konkurrencës së industrisë shqiptare si në tregjet vendase ashtu edhe në ato të huaja. Rritja e kapacitetit teknologjik të SME-ve shqiptare do t'i ndihmojë të konkurrojnë me më efikasitet dhe do të mbështesë integrimin ekonomik të Shqipërisë në tregjet globale. Gjithashtu, përmirësimi i kapaciteteve teknologjike të bizneseve, për t'i bërë ato më konkurruese, do të jetë një hap i rëndësishëm për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Mbështetja e inovacionit të biznesit – për ofrimin e ndihmës ndaj Ofruesve të Shërbimeve_të Biznesit (BSP-ve), si Agjencitë e Zhvillimit Rajonal (ARZH-të) dhe këshillimet, për të rritur kapacitetin njerëzor në auditimin e teknologjisë, menaxhimin e inovacionit, dhënien e informacionit si dhe lehtësimin e financimit për ndërmarrjet. Ky element ofron ekspertizën për t'u siguruar që financimi të ketë përfitime optimal. Pjesë e këtij objektivi është edhe plotësimi i boshllëkut institucional në Sistemin Kombëtar Shqiptar të Inovacionit. Do të përfitojnë rreth 500 biznese me informacione e grante nga disbursimi i Fondit të Inovacionit.

Zhvillimi i infrastrukturës do të mundësojë :

i) Krijimin e inkubatorëve (si në terma të hapësirës fizike ashtu edhe në ato të zhvillimit të shërbimeve për mbështetjen e biznesit) me detyrën për të ofruar një mjedis të favorshëm, për të favorizuar suksesin e mundshëm në shfaqjen e iniciativave të reja inovative të biznesit, duke krijuar vendeve të reja të punës, mundësi biznesi dhe rritje të vlerave, nëpërmjet rritjes së shëndetshme të bizneseve të reja inovative. Do të ndërtohet 1 inkubator teknologjik i biznesit.

ii) Mbështetjen e cluster-it të bizneseve në sektorë kyç, duke ofruar mbështetje për platformat bashkëpunuese, gjë që mund të mundësojë dhe mbështesë bashkëpunimin strategjik midis ndërmarrjeve dhe organizatave të tjera, për rritjen e zinxhirit të vlerës së produkteve dhe shërbimeve, duke favorizuar ndërkombëtarizimin dhe aksesin në tregje të reja. Do të ngrihen 3 klastera të reja.

Zhvillimi i kapaciteteve dhe transferimi i teknologjisë do të arrihet përmes sigurimit të informacionit, projekteve demonstruese, programeve të ndihmës teknike, trajnimeve të fuqisë punëtore dhe mbështetjes së institucioneve teknike, të tilla si qendrat e ekselencës dhe qendrat e inovacionit.

Nxitje për mundësi të reja biznesi në moshën dixhitale:

- Një përdorim sa më i mirë i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), do të jetë në shërbim të zhvillimit të bizneseve. Nisur nga fakti se TIK është një ndër instrumentet kryesor që shërben për rritjen ekonomike dhe në veçanti për një rritje më të shpejtë të SME-ve. Mbështetur edhe në axhendën dixhitale dhe të iniciativave flagship të politikes industriale te BE-se, fokusi qëndron në: *shfrytëzimin maksimal të potencialeve që ofron TIK, si në fushën e ofertës, për produkte dhe shërbime të reja dixhitale, ashtu edhe në anën e kërkesës, për një përdorim të zgjuar (smart) të këtyre teknologjive*. Duke ditur se tregu shqiptar është pjesë e kërkesës, investimi në teknologjinë dixhitale është e vetmja zgjidhje, ku çdo SME mund të bëhet konkurruese. Nga ana tjetër kjo konsiderohet për biznesin si një mundësi dhe njëkohësisht sfidë, pasi bizneset e vogla janë më pak të pajisura dhe i nevojitet kohë the kapital financiar për aplikimin e këtyre modeleve të reja të biznesit.

- *"Digital entrepreneurs"* konsiderohen ato biznese që shfrytëzojnë maksimalisht produktet dhe shërbimet dixhitale, duke përfshirë "cloud computing" (që i referohet të gjitha aplikimeve dhe shërbimeve të ofruara nëpërmjet internetit) që ndihmon në rritjen e konkurrueshmerise. Ne këtë kuadër iniciativa e BE-se: *"Përdorimi i zgjuar i teknologjisë së informacionit dhe integrimi i SME-ve në zinxhirin e vlerave të industrisë globale"* ndihmon SME-të shqiptare që të bëhen pjesë e rrjetit dixhital botëror.

DRAFT

- Objektiv i rëndësishëm mbetet ndërmarrja e një fushate ndërgjegjësimi për sipërmarrësit dhe SME-t të mbi përfitimet që sjell evolucioni i ri dixhital, nxitja dhe promovimi i historive të suksesit në tregun shqiptar. Gjithashtu puna për të lehtësuar dhe ndihmuar që kompanitë shqiptare të bëhen pjesë e networkut të Mentorëve Evropian, për qëllime trajnimi, këshillimi dhe për tu përfshirë sa më shumë në biznesin dixhital dhe për krijimin e partneriteteve të reja. Një përdorim sa më i mirë i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), aq me shumë do të ndihmohen bizneset që të zhvillohen, duke filluar me shërbimet qeveritare ato bankare me shërbimet dhe informacionet rreth produkteve të SME-ve dhe shërbimeve në përgjithësi. Të gjithë sektorët mund të përfitojnë nga hyrja online dhe përdorimi i teknologjisë moderne për promovimin, shitjen dhe shpërndarjen e produkteve të tyre në tregje deri tek konsumatori përfundimtar.

- Puna do të fokusohet në fuqizimin dhe mbështetjen e bizneseve fillestare start-ups për shërbime dixhitale dhe web dhe për alternativa në mbështetje financiare, siç janë skemat innovation voucher për TIK; për te garantuar një përdorim sa më të mirë të fondeve Europiane për rrjetin web dhe sipërmarrjen dixhitale, sipas prioriteteve dhe rregullave të zbatimit.

Përmirësimi i shërbimeve ndaj biznesit. Një rëndësi të madhe merr përmirësimi dhe shtimi i shërbimeve ndaj biznesit**,** nëpërmjet plotësimit dhe fuqizimit të portalit për SME-t, si dhe rrjetit me qendrat e informimit të biznesit; Kryerja çdo dy vjet e Analizës së nevojave për trajnime për biznesin, TNA; Menaxhimi i skemave të financimit për inovacionin, përmirësimi i shërbimeve on line për trajnime, pagesa, informacione, etj.

Sa i takon pagesës online çdo sipërmarrës në Shqipëri që ka në përdorim një smart phone ose një për shërbimeve të internetit, nuk është me i detyruar të shkojë tek zyrat e tatimeve për tu njohur me detyrimet e taksave apo të shkoje në sportelet e bankave për të bërë pagesën. *Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me suportin e AKSHI-t po i mundëson biznesit* q*ë t*ë *kryejnë dy aplikacione t*ë *reja nëpërmjet telefonit celular; i) aplikacioni i parë i pagesës elektronike i mundëson biznesit që t*ë *krijoje llogarinë e tij elektronike tek tatimet dhe njëkohësisht* të *lidhet me bankat për të bërë pagesën, pa qenë nevoja të jetë prezent fizikisht; ii) aplikacioni i dytë është mobile-tax (taksa nga celulari), nëpërmjet të cilit çdo tatim pagues në çdo kohë mund të marre informacion nga administrata tatimore për të paguar në kohë detyrimet.*

Me qëllim për të nxitur më tej shërbimet ndaj biznesit po zbatohet: ***Përhapja e metodës së bërthamës*** që synon mobilizmin e sipërmarrësve individuale, veçanërisht të SME-ve, nga ana tjetër edhe stimulimin e proceseve të zhvillimit organizativ në bazë dhome tregtie apo

shoqata biznesi. Zhvillimi i kësaj metode, e cila gjen zbatim edhe nëpërmjet asistencës teknike që sigurohet nga projekti GIZ/EDEP, synon të krijoj një platformë organizative ku sipërmarrësit të mund të flasin hapur, të identifikojnë më mirë problemet e tyre, të krahasojnë veten me të tjerët (benchmarking), të përcaktojnë kërkesën e tyre për shërbime, të zhvillojnë vete-besimin dhe të përmirësojnë biznesin e tyre. Ky proces lehtësohet me caktimin e konsulenteve të akredituar për SME me metodën e bërthamës (Nucleus approach). Gjithashtu në kuadër të shërbimeve të biznesit, gjatë viteve të zbatimit të kësaj strategjie do të organizohet *çdo vit, në muajin Tetor, java e sipërmarrjes dhe biznesit t*ë *vogël*, që do t'i shërbejë rritjes së ndërgjegjësimit dhe bilancit të arritjeve në zbatimin e kësaj strategjie në mbështetje të SME-ve.

5.3 KËRKIMI SHKENCOR DHE INOVACIONI

Përparësitë strategjike dhe objektivat për këtë sektor janë:

5.3.1 Përmirësimi i cilësisë së kërkimit shkencor në sektorin publik

- Mbështetja me programet nxitëse si **"Fondi i Ekselencës"** dhe "***Brain Gain*"** për kthimin periodik dhe afatshkurtër të lektorëve dhe shkencëtarëve shqiptarë të angazhuar në universitete të huaja. Trajnimi i kërkuesve të rinj përmes hapjes së disa shkollave pasuniversitare *si dhe* trajnimi i 1000 personave për doktoraturë.
- Rritja e aksesit të kërkuesve shkencorë në programet e kërkimit të BE *(Horizon 2020,COST, EUREKA,)* dhe bashkëpunimin me Qendrat Kërkimore të Përbashkëta *(JRC)* të BE përmes krijimit të 4-5 qendrave të ekselencës për periudhën 2016-2020, me prioritet në nivel rajonal. Rritja e numrit të aplikimeve në programet pjesëmarrëse të Hapësirës Evropiane të Kërkimit Shkencor *(Horizon 2020, Marie Curie, Erasmus for All)* me 15 % deri në 2020.
- Rritja e autonomisë dhe përgjegjësisë për institucionet hulumtuese me qëllim përmirësimin e kushteve të punës kërkimore dhe të kompetitivitetit të shkencëtarëve vendas përmes ndryshimit të kuadrit ligjor dhe normativ për shkencën.
- Përmirësimi i sistemit të vlerësimit të veprimtarive hulumtuese në institucionet e arsimit të lartë publik e privat, si edhe në institucionet e kërkimit dhe zhvillimit përmes vlerësimit të jashtëm sipas **"Platformës së Vlerësimit të Kërkimit Shkencor në Shqipëri"**, dhe akreditimit të institucioneve të kërkimit dhe të programeve e projekteve të kërkimit . Rritja e numrit të programeve të vlerësuara me 40 % deri në 2020.

5.3.2 Mbështetja sistematike për inovacionin dhe transferimin e teknologjisë në sektorin prodhues

- Rritja e bashkëpunimit mes ndërmarrjeve me aftësi teknologjike dhe institucioneve të arsimit të lartë në përcaktimin e kurrikulave të studentëve si dhe në realizimin e kërkimeve industriale pasuniversitare. Rritja me 25% e numrit të projekteve të përbashkëta ndërmjet sektorit publik të arsimit të lartë dhe sektorit privat deri në vitin 2020.
- Rritja e inovacionit dhe volumit të transferimit të teknologjisë nëpërmjet **"Programit Kombëtar për Teknologjinë dhe Inovacionin."** Në këtë program duhet të dominojë trekëndëshi i bashkëpunimit institucion publik, institucion akademik dhe biznes. Përfitimi i investimeve nëpërmjet konsorciumeve me institutet kërkimore akademike të 100 kompanive deri në vitin 2020. Modernizimi i sektorit të biznesit përmes stimulimit të kompanive të angazhuara në inovacion dhe transferimin e teknologjive të reja përmes fondeve programeve kombëtare dhe atyre të programeve ndërkombëtare IPA të BE-së si dhe fondeve në kuadrin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në Programin e Konkurencës dhe Inovacionit (COSME) dhe Rrjetit Evropian të Ndërmarrjeve (EEN).
- Përmirësimi i kuadrit normativ të të drejtave të pronësisë intelektuale për të nxitur transferimin e dijes dhe të teknologjisë përmes krijimit të lehtësirave për blerjen e patentave dhe përdorimin e teknologjive të reja. Numri i patentave dhe teknologjive të transferuara në ndërmarrjet shqiptare deri në 2020 parashikohet 25% më i lartë se 2012.

5.3.3 Përmirësimi i kapaciteteve institucionale të sistemit të kërkimit dhe inovacionit

- Fuqizimi i strukturave dhe rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve këshillimore, politikbërëse dhe zbatuese. Ngritja e Këshillit Kombëtar për Shkencën dhe Novacionin (KKSHN) si një strukturë këshillimore për qeverinë dhe parlamentin.
- Rritja e financimit për kërkimin shkencor përmes Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, të Programeve Ndërkombëtare (dypalëshe dhe shumëpalëshe) me synim financimin e këtij sektori me 1% të PBB në vitin 2020 . Rritja e kapaciteteve për Vlerësimin e Veprimtarisë kërkimore në vend duke përdorur treguesit standardë të OECD.

DRAFT

5.4 e-ARSIMI

Dixhitalizimi i sistemit arsimor synon integrimin në një nivel bashkëkohor të përdorimit të TIK në mësimdhënie e mësim-nxënie, ku të gjithë aktorët si mësuesit, prindërit, nxënësit, politikëbërësit dhe ofruesit e shërbimeve luajnë role të përcaktuara në krijimin e hapësirave të e-Edukimit si hap kryesor për kalimin gradual drejt një shoqërie dixhitale bazuar në dije.

Krijimi i infrastruktures individuale për shfrytëzimin e burimit të informacionit, krijon ambjentin e përshtatshëm të zhvillimit të kapaciteteve drejt një shoqërie të orientuar ndaj përdorimit të shërbimeve elektronike në shumë drejtime. Investimi i monitoruar dhe i koordinuar me zhvillimin e kapaciteteve përkatëse për përdorimin e tyre është një ndërmarrje e vështirë por perfaqëson një sfidë në drejtim të ndikimit kjo infrastukturë ka tashmë në nivelin e dijës dhe aftësive të individëve, dhe të shoqërisë në tërësi.

Dixhitalizimi i sistemit arsimor dhe i proçesit të nxënies konsiston në tri komponente kyçe:

Infrastruktura:

- Pajisja e shkollave me infrastrukturë funksionale për shfrytëzimin e informacionit (kompjuter, laptopë, tabletave smart).
- Internet me shpejtësi të lartë dhe mundësi aksesimi online edhe në mjedise të tjera brenda shkollave, jo vetëm në laboratorë.
- Mbështetje teknike që siguron efikasitet të përdorimit të infrastrukturës.
- Mundësi aksesimi në portale të nxënies në përputhje me kurrikulën e planifikuar si dhe në portale që mundësojnë monitorimin e rezultateve të nxënësve nga mësuesit dhe prindërit e tyre.
- Specifikimi i kuadrit ligjor dhe infrastrukturor për shkëmbimin online të informacionit, ndërmjet strukturave arsimore. DAR/ZA-të, cilat duhet të shkëmbejnë informacion të detyrueshëm në periudha kohore të caktuara, përmes teknologjive digjitale, si blogje, file sharing, social netëorking, videoconferencing etj.

Burimet për nxënie:

- Krijimi i përmbajtjeve digjitale me cilësi të lartë në gjuhën amtare, në përputhje me Kurrikulen kombëtare dhe kartën ndërkombëtare të kompetencave të rinisë.
- Përdorimi i rrjeteve sociale të sigurta për nxënësit dhe ndërgjegjësimi i larte për mbrojtjen e fëmijëve në internet.

DRAFT

- Krijimi i modelit kombëtar për ofruesit e përmbajtjeve digjitale në përputhje me kuadrin ligjor dhe infrastrukturor të shkëmbimit të informacionit midis ofruesve, organizatave kulturore, strukturave arsimore, që lehtëson dhe unifikon shkëmbimin e informacionit.
- Administrimi i të drejtës së autorit dhe pronësisë intelektuale.

Kompetencat profesionale të mësuesve

- Nxitja e modeleve të nxënies që efektivisht shfrytëzojnë përmbajtje digjitale për ngritjen e cilësisë në arsim (orë model, veprimtari demonstruese në klasa virtuale etj.).
- Vendosja e standardeve ndërkombëtare si ECDL, në lidhje me vlerësimin e kompetencave të mësuesve për përdorimin e TIK-ut, për nxitjen/trajnimin e mësuesve.
- Nxitja e shkëmbimit të përvojave dhe të praktikave ndërmjet shkollave dhe mësuesve.

Rrjetëzimi i institucioneve të arsimit të lartë publik e privat si pjesë aktive e rrjetit akademik shqiptar do të mundësojë grumbullimin, përpunimin dhe gjenerimin e informacioneve unike si dhe mundësinë e përfitimit të shërbimeve online nga këto instuticone.

Kjo shoqërohet me:

- Përmirësimin e kuadrit legjislativ në drejtim të unifikimit të politikave për përfshirjen e të gjithë IAL-ve (Institucioneve të Arsimit të Lartë) private e publike në një rrjet akademik unik
- Përmirësimi i infrastrukturës fizike per ofrimin e shërbimeve online pranë IAL-ve private e publike
- Zhvillimi i kompetencave në përfitimin e këtyre shërbimeve të ofruara nëpërmjet optimizimit te shërbimeve të ofruara në sistemet software-ike.

5.5 INFRASTRUKTURA KOMBËTARE E INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR

Kjo Infrastrukturë synon krijimin e tre shtresave bazë:

1. Shtresa e informacionit, që përmban të gjithë informacion dixhital të strukturuar dhe të pa strukturuar.
2. Shtresa e platformës, që përfshin të gjitha sistemet dhe proceset e përdorura për të menaxhuar këtë informacion.
3. Shtresa e prezantimit, që përcakton mënyrën sipas të cilës është organizuar informacioni dhe si ofrohet ai për publikun. Kjo shtresë paraqet mënyrën se si qeveria dhe biznesi privat ofrojnë informacion dixhital për qeverisjen nëpërmjet internetit, aplikacioneve mobile apo me mënyra të tjera.

Këto shtresa të ndara, krijimi i informacionit dhe prezantimi i informacionit do të mundësojnë së pari krijimin e informacionit dhe të dhënave dhe më pas përdorimin e tyre në mënyra të ndryshme.

Parimet në të cilat do të mbështetet kjo Infrastrukturë:

a) "Orientim nga Informacioni " kalon nga menaxhimi i "dokumentave" në menaxhimin e një pjese të veçuar të përmbajtjes së "open data" të cilat janë të sigurta, të sistemuara dhe paraqiten në mënyrën më të përshtatshme për përdoruesin e informacionit.
b) "Platformë e Përbashkët" na ndihmon për të punuar së bashku si brenda një institucioni ashtu edhe midis institucioneve të ndryshme, duke reduktuar kostot, duke strukturuar zhvillimin dhe duke zbatuar standarte të qëndrueshme për të siguruar konsistencë në krijimin dhe ofrimin e informacionit dixhital.
c) "Orientim nga Klientit" influencon mënyrën se si krijojmë, menaxhojmë dhe prezantojmë të dhëna nëpërmjet web siteve, aplikacioneve mobile dhe mënyrave të tjera që lejojnë përdoruesit ta formatojnë, ta ndajnë midis tyre dhe ta konsumojnë informacionin kur dhe ku të dëshirojnë ata.
d) Një platformë "Sigurie dhe Privatësie" e cila siguron se ky inovacion bëhet simbas një mënyre që na garanton siguri në ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve dixhitale duke mbrojtur informacionin dhe privatësinë.

Krijimi i kësaj Infrastrukture do na mundësojë njëkohësisht dhe implementimin e Direktivës së BE, INSPIRE si një kusht i rëndësishëm për integrimin e vendit në BE.

Kjo Infrastrukturë do rezultojë në krijimin e " GIS-it kombëtar".

Ne jemi koshientë tashmë se teknologjia GIS na jep një mundësi unike për të integruar të dhënat nga institucionet dhe agjensitë e ndryshme qeveritare të të gjitha niveleve.

Duke e pasur këtë mundësi, GIS bëhet një instrument i fuqishëm në duart e vendimmarjes sepse vetëm ai mund të japë informacionin më të plotë dhe më të saktë për tema që i interesojnë vendimmarjes, të cilat lidhen me administratën, financat, ekonominë, infrastrukturën dhe burimet e ndryshme natyrore.

Të gjithë këtë informacion, GIS, e organizon, mbi një hartë apo imazh që tregon elemente bazë gjeografike si topografia, rrugë, parcela, ndërtesa, rrjete infrastrukturore, kufij administrative apo fizikë.

Duke qënë se një GIS Kombëtar integron informacion nga shumë burime dhe autorë duke u mbështetur fuqimisht në rrjete, harduerë dhe softuerë ndërveprues, ai na sjell të bashkuara një përshkrim gjithpërfshirës të të gjitha aseteve dhe burimeve kyçe kombëtare me të cilat operon një qeveri në rrugën e realizimit të misionit që ka.

Pra, "GIS-i Kombëtar", do të bëhet kështu një resurs kombëtar i paçmueshëm, një instrument i pazëvendësueshëm për vendimmarjen, në hartimin, ndjekjen dhe zbatimin e politikave zhvillimore.

5.6 e-MJEDISI

Në lidhje me dixhitalizimin e të dhënave për një menaxhim sa më të mirë të mjedisit janë parashikuar sa vijon:

a) Akses elektronik në Zonat e Mbrojtura

Kjo lidhet me sigurimin e transparencës me publikun dhe aktoret e interesuar gjatë vendim-marrjes dhe iniciativave ligjore në fushën e natyrës. Aktivitetet e planifikuara konsistojnë në krijimin e një portali online për akses nga publiku dhe aktorë në draft dokumenta ligjore te cilat jane ne proces hartimi.

Rezultatet e pritshme konsistojnë : Akses online në dokumentacionin, strategjitë dhe legjislacionin ekzistues të fushes së mbrojtjes së natyrës.

- Bërjen publike të Zonave të Gjuetisë të miratuara dhe hartave GIS .
- Rritje e transparencës për konsultim dokumentash i cili do të përmirësojë në procesin e marrjes së vendimeve.
- Promovimin e vlerave natyrore të Shqipërisë.
- Uljen e kohës së procesimit të marrjes së mendimit nga publiku.
- Rritjen e transparencës për projektet që janë në implementim dhe do të implementohen.

DRAFT

b) Speedy Project IPA Adriatic CBC

Projekti ka për qëllim bashkëpunimin rajonal mbi të dhënat e cilësisë së ajrit në rajon dhe ka për qëllim krijimin e një portali online për akses nga publiku dhe aktorët e ndryshëm në draft dokumenta ligjore të cilat janë në proces hartimi. Portali do të krijojë mundësinë e transparencës mbi të dhënat e cilësisë së ajrit në vendet e rajonit, duke i dhënë suport bashkëpunimit rajonal në marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Është përcaktuar pamja grafike dhe ajo e përmbajtjes së platformës e cila për momentin është në fazën e testimit. Është mbyllur draft raporti për zhvillimin e një modeli të përbashkët të punës dhe po priten komente dhe sygjerime nga partnerët.

c) Aplikimi i sistemeve të monitorimit me kamera në sipërfaqet pyjore, me synim parandalimin e zjarreve dhe evidentimin e prerjeve të paligjshme.

Ky projekt synon survejimin e pandërprerë të pikave kryesore të kryqëzimeve të rrugëve autopyjore ku transportohet materiali drusor me qëllim monitorimin dhe kontrollin e transportit të paligjshëm të lëndës drusore dhe krijimin e një sistemi reagues për kapjen dhe ndëshkimin e autorëve të këtij aktiviteti të paligjshem. Gjithashtu, sistemi duke shfrytëzuar kapacitetet e tij do të përdoret dhe për survejimin e zonave pyjore duke bërë dhe zbulimin e vatrave të zjarreve dhe përcaktimin e ndodhjes së zjarrit.

Duke qënë se sistemi do të bëjë monitorim 24 orësh, kjo do të krijojë mundësinë e marrjës së informacionit për të gjitha hyrje daljet në pyje duke lehtësuar punën për identifikimin e autorëve të aktiviteteve të paligjshme në pyje duke përfshirë përveç prerjeve të paligjshme dhe zjarreve edhe aktivitetin e gjuetisë.

d) Ndërtimi i kadastres elektronike kombëtare të burimeve ujore

Ky aktivitet ka si qëllim ngritjen e infrastrukturës për menaxhimin e burimeve ujore nga ana cilësore dhe sasiore në nivel baseni kombëtar nëpërmjet sistemit GIS.

Kadastra kombëtare e burimeve ujore e menaxhuar nëpërmjet sistemit GIS do të ndihmojë në manaxhimin e integruar të burimeve ujore falë realizimit të balancës së burimeve ujore,

analizave të përdoruesve të burimeve ujore, kontrollit të përdorimit të sasisë si dhe të cilësisë së burimeve ujore.

Gjithashtu, do të ndihmojë në krijimin e planeve të reja të biznesit dhe zhvillimit në fushën e ujërave, identifikimin e nevojave për ndërhyrje, modelim dhe projektim të permbytjeve si dhe ndërhyrjeve të tjera madhore në këtë sektor.

5.7 e-SHËNDETËSIA

5.7.1 Ngritja e "Sistemi i checkup-it për grup moshën 40-65 vjeç"

Gjatë 2014 do të fillojë zbatimi i një programi kombëtar për kontrollin bazë të shëndetit për popullsinë. Ky kontroll do të përfshijë intervalin e moshës 40-65 vjeç si dhe mosha më të reja për disa shtresa të veçanta të shoqërisë, në total 900.000 shtetas. Do të ngrihet një sistem unik dixhital shëndetësor, me të cilin do të ndërlidhen të gjithë aktorët e sistemit shëndetësor, publikë dhe privatë. Në qendër të sistemit do të jetë individi dhe dosja e tij elektronike shëndetësore.

5.7.2 Sistemi i mbledhjes dhe raportimit të të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, publik ose privat.

Qëllimi i këtij sistemi është mbledhja, raportimi i të dhënave dhe standardizimi i informacionit shëndetësor që do të raportohet nga të gjithë ofruesit e kujdesit shëndetësor, publikë dhe privatë, që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.

5.7.3 Sistemi i regjistrimit dhe kontrollit të barnave

Qëllimi i këtij projekti është ndërtimi i Regjistrit Elektronik për regjistrimin e kërkesave për regjistrimin e barnave mjekësore.

`Nëpërmjet këtij projekti do të mund të arrihet:

DRAFT

- Ndërtimi i Regjistrit Elektronik për regjistrimin e kërkesave për regjistrimin e një bari mjekësor
- Ndërtimi i portalit të klientit për: Importuesit, depot shpërndarëse, prodhuesit dhe shtëpitë farmaceutike. Ndërtimi i Modulit me Web Service për ekspozimin për të tretët (FSDKSH) inventarëve të importuesve, depove shpërndarëse, prodhuesve dhe shtëpive farmaceutike.
- Ndërtimi i modulit me Web Service për ekspozimin e të dhënave të barnave mjekësore
- Moduli i regjistrimit dhe Inventarizimit të numrave serial të pullave
-

5.7.4 Sistemi i gjurmimit të barnave mjekësore (Track and Trace)

Qëllimi i këtij projekti është për ndërtimin e një sistemi ku në çdo moment të kohës të mund të gjurmohet vendndodhja e një bari që ka nje pullë të caktuar.

Rezultatet të cilat pritet të arrihen janë:

- Sigurimi i një mekanizmi të sigurtë për gjurmimin e shpërndarjes së barnave
- Shmangie të abuzimeve me barnat.
- Inventarizm të pullave të barnave mjekësore dhe gjurmim të barit mjekësor në çdo moment të kohës sipas pullës së barit

5.7.5 Receta Elektronike (e-Prescription)

Sistemi e-Prescription do të eleminojë recetat e gjeneruara në kartë me e-receta që do të mund të aksesohen online nga palët e përfshira në këtë proces:

a. Mjekët

b. Pacientët

c. Farmacistët

Rezultatet të cilat priten të arrihen janë:

- Sistemi e-Prescription do të rrisë eficencën dhe saktësinë e përcaktimit të ilaçeve duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së shëndetit të pacientëve dhe kujdesit shëndetësor.

DRAFT

- Sistemi e-Prescription do të ulë mundësinë e dhënies së ilaçeve të gabuara për pacientët.
- Sistemi i e-Prescription duke shkëmbyer informacion automatik online me regjistrin elektronik të rekordeve shëndetësore do të eleminojë dhënien e ilaçeve të gabuara që shkaktojnë reaksion te pacienti.
- Sistemi e-Prescription do të mundësoje ndërtimin e një game alertimi në rastet kur mjeku ka përcaktuar një ilaç të gabuar dhe që shkakton reaksion te pacienti, duke u mbështetur te historiku i kurimit të pacientit.

  Sistemi e-Prescription do të zvogëlojë mundësinë e gabimeve që vijnë si pasojë e keqkuptimeve në shkrim midis mjekëve dhe farmacistëve.

5.7.6 Sistemi informatik për menaxhimin e spitaleve (Hospital Information System)

Qëllimi i projektit është ndërtimi i një sistemi informatik për menaxhimin e spitaleve që do të bëjë të mundur:

- menaxhimin efikas të spitaleve.
- përmirësim të kujdesit për pacientin
- sistem për menaxhimin spitalor, ADT (Admission Discharge Transfer), pranimi, shtrimi, ekzaminimet mjekësore laboratorike, kartela e pacientit, menaxhimi i shtretërve, menaxhimi i farmacive spitalore, shkarkimi i barnave te pacientët, dalja.
- menaxhimi llogjistik dhe financiar i spitalit si ndërmarrje
- përmirësim të efikasitetit të punës
- përmirësim të kontrollit të aktiviteteve spitalore

5.7.7 Sistemi i Regjistrimit të Imunizimit dhe Inventarit të Vaksinave

Projekti do të mundësojë zgjerimin e regjistrit elektronik për imunizimin dhe inventarizimin e vaksinave në qendrat shëndetësore**.**

Rezultatet të cilat pritet të arrihen janë:

- Imunizim në kohë dhe të barabartë për të gjithë fëmijët

DRAFT

- Ndërtimi i një regjistri imunizimi me të dhëna të sakta që do të përdoret për një menaxhim sa më të mirë të programeve të vaksinimit.
- Ndërtimi i inventarit të vaksinave në institucionet e qendrave spitalore.
- Parashikim pro-aktiv të sasive të vaksinave për çdo qendër shëndetësore sipas fëmijëve të regjistruar në to.
- Identifikim i fëmijëve që nuk kanë kryer imunizimin sipas qendrave shëndetësore.
- Monitorim i procesit të imunizimit në rang kombëtar.

5.7.8 Sistemi kombëtar Portal për Pacientët dhe i shërbimeve elektronike për qytetarët

Ndërtimi i Portalit Elektronik të Pacientit në cilin do të bëhet e mundur që të shfaqjet i gjithë historiku i shëndetit të shtetasit.

Do të bëhet e mundur për mekanizma informatike të cilat do të realizojnë mbledhjen e informacionit nga burime të ndryshme dhe paraqitjen e këtij informacioni në Portalin Elektronik të Pacientit.

5.7.9 Sistemi i monitorimit të indikatorëve të performancës së sistemit shëndetësor

Ndërtimi i software-it për integrimin, konsolidimin, monitorimin e të dhënave të sistemeve të kujdesit shëndetësor dhe ndërtimi i indikatorëve dhe analizave për raportim që do të krijojë mundësinë e gjenerimit të statistikave dhe raporteve sipas fushave të aktivitetit të institucioneve të kujdesit shëndetësor. Objektivi i këtij sistemi do të jetë konsolidimi i të dhënave të institucioneve të kujdesit në një bazë të dhënash të integruar, si pjesë integrale e sistemit të statistikave dhe raporteve analitike

5.7.10 Sistemi i menaxhimit të stafit dhe aseteve mjekësore

Ky projekt do të realizoje ndërtimin e një sistemi informatik për menaxhimin e stafit dhe aseteve mjekësore.

DRAFT

Përmes këtij sistemi synohet që:

- të informatizohet menaxhimi i organigramës, burimeve njerëzore dhe pagat e stafit të institucioneve shëndetësore.
- të informatizohet regjistrimi i të gjithë personelit mjekësor dhe jo mjekësor.
- të informatizohet regjistrimi dhe inventarizimi i objekteve të patundshme.
- të informatizohet regjistrimi dhe inventarizimi i paisjeve mjekësore.

5.7.11 Projekti "eHealth – Rekordi Elektronik Shëndetësor Kombëtar"

Qëllimi i projektit është: "Sigurimi i aksesit në të dhënat shëndetësore të pacientëve, nga profesionistët e kujdesit shëndetësor në të gjithë vendin, nëpërmjet realizimit të një sistemi elektronik informacioni të sigurtë."

Institucionet e parashikuara për t'u përfshirë në këtë sistem janë të gjithë spitalet rajonalë, spitalet e rretheve, spitalet universitare dhe të gjithë poliklinikat e rretheve, pra rreth 78 institucione.

5.8 SIGURIA KOMPJUTERIKE

Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike - ALCIRT është krijuar në kuadër të projektit të USAID me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.766, datë 14.9.2011.

Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterikë është nga prioritetet kryesore të ALCIRT. Kjo strategji do vendosë bazat dhe do japë objektivat kombëtare për zhvillimin e sigurisë kombëtare kompjuterike. Miratimi i kësaj strategjie është edhe një detyrim i Shqipërisë ndaj NATO-s. Në kuadër të hartimit dhe miratimit të një dokumenti politikash për sigurinë kibernetike, ALCIRT ka vlerësuar strategjitë e vendeve anëtare të NATO-s dhe situatën kombëtare në këtë fushë. Me urdhër të Kryeministrit nr. 120, date 23.03.2014 është ngritur grupi ndërinstitucional i punës "Për hartimin e dokumentit të politikave për sigurine kibernetike".

Synimet per sigurine kibernetike 2014-2020 përfshijnë:

1. Ndërgjegjësimi ndaj rrezikut të krimit kibernetik:

a. Krijimi i një portali ndërgjegjësimi me fokus sigurinë kompjuterike, fëmijet në internet, biznesin, këshilla sigurie dhe artikuj.

b. Fushata ndërgjegjësimi në Fakultetet e drejtimit TIK në formën e leksioneve të hapura, seminareve.

c. Ndërgjegjësim përmes materialeve informuese (fletëpalosje, broshura, poster);

d. Organizimi i konkurseve me fokus sigurinë për evidentimin e talenteve të reja në këtë fushë.

2. Mbrojtja e sistemeve të informacionit që sigurojnë funksionimin e shërbimeve jetike të shoqërisë.
3. Hartimi/implementimi i një standardi baseline sigurie për administratën publike për nivelin e sigurisë së nevojshme në sektorin publik.
4. Procedurat për menaxhimin e incidenteve.
5. Monitorimin periodik të procedurave.

5.9 QEVERISJE E HAPUR NËPËRMJET PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJISË

Angazhimet e reja të Qeverisjes së Hapur për planveprimin 2014-2016 përfshijnë zgjerimin e angazhimeve origjinale, si dhe nisjen e iniciativave të reja. Përmendim këtu ndër të tjera :

- Regjistri elektronik i autorizimeve, lejeve dhe marrëveshjeve të nxjerra nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë
- Regjistrit Elektronik Kombëtar të Përfituesve të Ndihmës Ekonomike.
- Portalin Elektronik për menaxhimin e burimeve ujore
- Aksesi Elektronik në Zonat e Mbrojtura

Në total ky plan veprim përmban 13 angazhime, të cilat në pjesën më të madhe të tyre lidhen në mënyre të drejtëperdrejtë me përdorimin e teknologjisë për të ofruar një qeverisje më trasparante për qytetaret dhe duke garantuar një ulje drastike të korrupsionit në administratën publike.

5.10 QEVERISJA ELEKTRONIKE VENDORE (E-QV)

Me hyrjen ne fuqi dhe zbatimin e Ligjit për për Ndarjen Administrativo – Territoriale të Republikës së Shqipërisë, pushteti vendor do jetë i organizuar në 61 njësi të reja të qeverisjes

vendore, të cilat do të kenë në administrim nga 3 deri në 15 njësi të qeverisjes vendore aktuale (kryesisht komuna). Qeverisja elektronike konsiderohet si një prej formave që do të mundësojë menaxhimin efiçent të të njëjtave funksione[7], për një territor dhe popullsi shumë më të madhe; do të lejojë ushtrimin e demokracisë lokale përmes shfrytëzimit të instrumentave të pjesëmarrjes lehtësuar nga teknologjia, sikundër edhe bashkërendojë funksionet e ushtruara në të dy nivelet lokal dhe qëndor. Niveli vendor do të përfshihet në raportet zyrtare të monitorimit.

5.10.1 e-Pjesëmarrja dhe qeverisja e hapur vendore

Faqja e internetit përbën sot bazën e vlerësimit të maturimit të e–QV, nisuar nga faza e prezencës në internet (faza e zgjeruar, faza interaktive, faza e transaksioneve online dhe faza e të qënurit të lidhur elektronikisht). Në parim, të gjitha të dhënat e mbajtura dhe të menaxhuara nga QV duhet të jetë të hapura dhe në dispozicion të publikut, përveç rasteve kur ka ndjeshmëri specifike apo pengesë ligjore. Të dhënat vendore të hapura garantojnë transparencën, llogaridhënjen, përfshirjen dhe fuqizimin e komunitetit. Të dhënat e QV do të konsiderohen të hapura nëse janë në përputhje me këto parime: të plota, parësore, të ofruara në kohë, lehtësisht të qasshme, të procesueshme, jodiskrimiuese dhe të mos jenë subjekt i të drejtave të pronës, patentës, markës apo rregullave të tjera8.

Në funksion të garantimit të infrastrukturës teknike dhe ligjore, strategjia do të fokusohet në:

- Miratimin nga AKSHI të standarteve bazë të ndërtimit të faqes së internetit për QV dhe i kritereve të vlerësimit të faqes së internetit të QV.
- Unifikimi i DNS të QV me <bashkia.gov.al>.
- Detyrim ligjor të QV për të patur prezencë me faqe zyrtare në internet sipas standarteve bazë të AKSHI-it.
- Pilotimin i portalit të QV, si portal që mundëson në një faze të dytë lidhjen me portalin e–Albania.al.
- Optimizimin e faqeve të internetit të QV për pajisje mobile (smart phone, tabletat).
- Optimizimi i përdorimit të aplikimit web-based të akteve vendore, të aplikimit e–Pjesëmarrje dhe "Rregulloj Qytetin Tim" (në ato QV që është instaluar dhe përdoret).

[7] Varësisht nga Strategjia e re e Decentralizimit, e cila mund të parashikojë edhe delegimin e funksioneve shtesë në nivel vendor
[8] http://www.opengovdata.org/home/8principles

5.10.2 Sistemet e interoperabilitetit QQ-QV

TIK po mundëson menaxhimin gjithnjë e më efektiv të njohurive, të të dhënave, si dhe bashkëpunimin horizontal dhe vertikal mes agjencive qeveritare. Zhvillimi i bazave të të dhënave në QV dhe QQ, me standarte dhe që ndërveprojnë mes tyre, është kusht për krijimin e portaleve në QV dhe QQ dhe ofrimin e e–shërbimeve që kanë në qendër të tyre përdoruesit e shërbimeve.

Një qasje e tillë do të fokusohet në:

- Përcaktimin organizativ, semantik dhe teknik të QV në realizimin e Kornizës Kombëtare të Rregjistrimit të bazave të të dhënave të QV tek AKSHI.
- Ndërveprimin e sistemeve të qeverise elektronike.
- Ndërveprimin e bazave të të dhënave të QV me QQ drejt portalit e–Albanian.gov.al.
- Ndërveprimin e QV me bazën e të dhënave të QKR, ZRPP, Thesarit, AKPT, Regjistrit Kombëtar të Shtetasve, DAP–menaxhimi i burimeve njerëzore, APP), etj.

5.10.3 Z1N (Zyra elektronike me 1 Ndalesë)

Përgatitja e QV për të ofruar e–Shërbime është një ndërmarrje që integron elektronikisht sisteme, platforma, aplikime, baza të dhënash, njësi orgnizative, institucione, dhe e ekspozon QV ndaj proceseve, praktikave dhe standarteve krejtësisht të reja në ofrimin e shërbimeve. Legjislacioni kombëtar ka përcaktuar disa standarte dhe tregu privat TIK ka zhvilluar tashmë disa programe/ aplikime për nevojat e QV për shërbime elektronike. Ofrimi i Shërbimeve të Sektorit Publik për e–QV duhet të shfrytëzojë asistencën dhe teknologjitë më të fundit të TIK, të cilat duhet të synojnë sigurimin e shërbimeve të përqëndruara për QV dhe të përshpejtojë zhvillimin e e–QV në Shqipëri.

Projekti i e-Z1N (one stop shops) ka për qëllim sigurimin e shërbimeve sa më afër qytetarit dhe biznesit, pavarësisht riorganizimit dhe ndarjes administrative dhe territoriale të QV-së. Zyrat me 1 Ndalesë do të mundësojnë që shërbimet që ofrohen sot në njësitë ekzistuese të vazhdojnë të ofrohen duke siguruar një infrastrukture të integruar të Z1N-ve brenda njësisë së re të QV-së.

Realizimi i këtij projekti do bëhet në dia faza dhe to të fokusohet në:

- Studimi i fizibiletit të funksioneve, shërbimeve dhe sekuencës së shkëmbimit/ofrimit të të dhënave dhe nivelit të dixhitalizimit të NJQV-ve ekzistuese.
- Projektimi i e-Z1N të integruar për njësitë e reja të QV.

DRAFT

- Hartimi i standarteve të digjitalizimit të strukturuar të të dhënave, dokumenteve, hartave dhe informacioneve të QV.
- Zhvillimi i standarteve të infrastrukturës hardware për QV.
- Lidhja e QV me internet të shpejtë broadband

Pilotimi i e-Z1N të integruar në një njësi me më shumë se 10 Z1N

5.11 Internet Broadband për Zonat Malore

Projekti "Promovimi i Lidhjes me Internet Broadband në Bjeshkët e Namuna" synon të prodhojë një kuadër zhvillimi dhe të implementojë shembujt më të mirë mbi reduktimin e hendekut dixhital dhe mbështetjen e zhvillimit socio-ekonomik në zonën e Bjeshkëve të Namuna. Komunitetet lokale, përfshirë strukturat qeverisëse, bizneset dhe qytetarët do të përfitojnë nga disponueshmëria e lidhjes me Internet Broadband. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të promovojë rritjen socio-ekonomike dhe kompetitivitetin në zonën kufitare malore nëpërmjet shërbimeve të internet broadband duke mundësuar lidhjen e 22 objekteve social ekonomike, përfshirë komuna, zyra informacioni, qëndra shëndetësore dhe hotele të zonës me lidhje internet broadband të siguruara nëpërmjet antenave satelitore ose teknologji të tjera të mundshme për terrenin, si dhe wi-fi për zonën. Gjithashtu projekti do të mundësoje dixhitalizimin e muzeut historik të Shkodrës.

Nëpërmjet rritjes dhe zgjerimit të aksesit e konektivitetit në internet broadband në zonat e izoluara të "Bjeshkëve të Nëmuna", permes pajisjes me antena satelitore dhe teknologjive të tjera, projekti do kontribuojë në realizimin e disa objektivive të Programit Axhenda Digitale 2014-2020 sic janë:

1. Sigurimi i lidhjes me internet broadband në të gjithë vendin
2. Reduktimin i hendekut dixhital, duke forcuar arsimimin digital dhe zhvilluar aftësitë për përdorimin e TIK-ut
3. Rritjen e shkallës së përdorimit të shërbimeve elektronike në vend
4. Nxitjen e frymës së inovacionit dhe perparimin drejt shoqërisë së dijes

5.12 I-Learn/ Unë mësoj

Ky projekt, synon ta përdorë teknologjinë dhe avantazhet që ajo ofron për elementin më bazik dhe që i shoqëron gjatë gjithë jetës fëmijët që nuk dëgjojnë, edukimin.

DRAFT

Procesi i mësimdhënies për këtë grup fëmijësh që nuk dëgjojnë do të lehtësohet nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje pilot duke mundësuar lehtësimin e procesit të mësimdhënies përmes një programi të personalizuar posaçërisht për ta në tabletat të cilat do t`u vihen në dispozicion. Një program kompjuterik i specializuar do të zhvillohet për të siguruar komunikimin nëpërmjet gjuhës së shenjave, program i cili do të ndikojë pozitivisht në shmangien e disa vështirësive siç është vështirësia e të shpjeguarit nga ana e mësuesve si dhe komunikimi interaktiv mes tyre dhe nxënësve të tjerë pa probleme dëgjimi.

Kjo platformë e-learning, do të integrojë alfabetin multimedial daktilografik dhe fjalorin e gjuhës së shenjave të plotësuar edhe me përkthimin përkatës në gjuhën e folur. Platforma do të përfshijë gjithashtu programe, leksione për përdorimin e gjuhës së shenjave, si dhe ushtrime të posaçme për këta nxënës.

Projekti do të bëjë të mundur sigurimin e 450 tabletave ku fëmijët që nuk dëgjojnë do të praktikojnë metodologjinë e-learning duke përdorur platformën digitale që do të vendoset në dispozicion të tyre dhe teknologjinë e informacionit.

5.13 Inovacioni kundër korrupsionit

Ndërtimi i një modeli të qendërzuar të ofrimit të shërbimit për qytetarët në Shqipëri

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë për herë të parë reformën për ofrimin e integruar të shërbimeve publike që do të ofrohen nga administrata publike në qendrat me një ndalesë (PSM).

Programi "Inovacioni kundër korrupsionit", ka për qëllim për të reformuar konceptin e shërbimit publik duke kontribuar në modernizimin e shërbimeve publike, duke thjeshtuar, integruar procedurat dhe unifikuar ofrimin e shërbimeve në një qendër të vetme (Qendër e Shërbimit Publik). Programi gjithashtu do të kontribuojë në një nga prioritetet e Qeverisë - luftën kundër korrupsionit.

Ky mision i dyfishtë (përmirësimin e shërbimeve publike dhe lufta kundër korrupsionit) do të arrihet duke zbatuar një seri reformash; risi të procedurave administrative, si dhe mjetet dhe instrumentet e nevojshme TIK për shpërndarjen e shërbimeve në një format të PSM. Këto procedura të reja të thjeshtuara dhe të facilituara nga TIK do të kontribuojnë në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në ofrimin e shërbimeve dhe në një rritje të transparencës dhe llogaridhënies së Administratës Publike në drejtim të qytetarëve dhe bizneseve.

1. **Qëllimi i PSM**

Rritja e përftimit, përmirësimi i ofrimit të shërbimeve, dhe reduktimi i Korrupsionit.

- Zvogëlimi i kohës dhe shpenzimeve të qytetarëve në marrjen e shërbimeve publike
- Marrja e shërbimeve në një dritare të vetme (single ëindoë)
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve duke përdorur zgjidhje të reja inovative
- Rritja e besimit dhe kënaqësisë së qytetarëve nga mënyra e ofrimit të shërbimeve nga administrata.

Për këtë arritur këtë objektiv madhor të qeverisë do të ndiqen disa hapa të cilat konsistojnë në:

- Përmirësimin e mjedisit rregullator dhe rindërtimit të strukturës së re inxhinierike duke ndërtuar koordinimin institucional;
- Ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme; (Dixhitalizimi dhe Modernizimi + Ndërtim);
- Vendosjen e një sistemi monitorimi të brendshëm
- Model të qendërzuar të ofrimit të shërbimit
- Rritja e përgjegjshmërisë duke publikuar rezultatet e performancës;
- Përmirësimi dhe Konsolidimi i Zhvillimit të Infrastrukturës ITC

DRAFT

6 ANALIZA SWOT (STRENGTH, WEAKNESS, OPPORTUNITIES, THREATS)

Për hartimin e kësaj strategjie është hartuar një analizë SWOT që lidhet me pikat e forta, të dobta, mundësitë dhe kërcënimet që mendojmë se mund të ndikojnë në mos realizimin e suksesshëm të saj.

Fortësitë ✓ Qeverisje dhe udhë e qartë dhe mirëcaktuar për dixhitalizimin ✓ Institucione funksionale të angazhuara për implementimin e strategjisë për axhendën dixhitale ✓ Një sistem i strukturuar sipas përparësive, veprimeve dhe indikatorëve që do merren si bazë për administratën qendrore dhe lokale lidhur me inovacionin dhe rritjen dixhitale - Afatet e parashikuara për planin e veprimeve dhe zbatimin e tyre të shpejt, të mirëpërcaktuar dhe të monitoruar, ✓ Rritja e përdorimit të internetit nga qytetarët shqiptar nëpërmjet uljes së Hendekut Dixhital ✓ Orientimi drejt Smart Cities dhe ✓ Vendosja e qytetarëve në qendër të strategjisë	**Dobësitë** Niveli aktual i dixhitalizimi i kufizuar në krahasim me vendet e rajonit dhe ato të Evropës Nevojë për investime madhore për të arritur nivele të krahasueshme me rajonin dhe BE Mungesë e profesionistëve të specializuar në fusha të caktuara të TIK Nivel i ulët i kulturës dixhitale në popullatë
Mundësitë Përcaktimi i një koordinimi strategjik operativ dhe nivel bashkëpunmi strukturor i të gjithë aktorëve publik Një strategji e qartë e mirëpërcaktuar që lejon sektorin privat që të përcaktoj planin e investimeve në afatin e gjatë dhe të mesëm.	**Kërcënimet** Fragmentizimi i burimeve dhe mbivendosja e investimeve Mundësi e mos shfrytëzimit të ekonomive të shkallës Mungesë sinergjish gjatë procesit të koordinimit

DRAFT

Ofrimi i shërbimeve të unifikuara të shërbimeve publike për qytetarët	

DRAFT

7 LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

Formimi i Shoqërisë së Informacionit kërkon vëmendje të veçantë nga ana e institucioneve publike. Ato duhet të përcaktojnë kushtet e nevojshme për të përshpejtuar proceset e përfshirjes aktive të sektorit privat dhe publik për të diskutuar rregullimet e reja, si dhe implementimin dhe monitorimin e zbatimit të strategjisë.

Analiza e Nevojave:

1. Krijimi i një mase kritike (infrastrukturë dhe shërbime TIK), që lejojnë zhvillimin e shpejtë dhe të mëtejshëm të Shoqërisë së Informacionit dhe përafrimi me nivelet e vendeve të rajonit dhe më gjerë mund të arrihet vetëm nëpërmjet përpjekjeve të sektorit privat dhe një kuadri rregullator të mirë. Për këtë arsye është e nevojshme ndërhyrja financiare qeveritare.

2. Arritja e rezultateve të kërkuara dhe të qëndrueshme si dhe sigurimi i procesit të monitorimit të tyre mund të jetë i vështirë nëse mjetet dhe veprimet e përcaktuara në këtë strategji si dhe dokumentet e tjerë kombëtar mbeten të pa mbuluara financiarisht.

Institucionet Qeveritare luajnë një rol udhëheqës në termat e:

- Legjislacionit lidhur me Shoqërinë e Informacionit për rregullimin minimal në interesin publik dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve;
- Zhvillimin e politikave për të nxitur veprimtari dhe projekte me rëndësi kombëtare;
- Pjesëmarrjen në marrëveshje ndërqeveritare për të arritur objektiva global dhe luftuar krimin ndërkombëtar

Institucionet qeveritare duhet të nxisin sektorin privat dhe OJQ-të që të marrin pjesë në fushatat e edukimit dhe ndërgjegjësimit për implementimin e politikave publike lidhur me transparencën dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe në vetë vendim marrjen për zhvillimin e fushave të caktuara të Shoqërisë së Informacionit.

E rëndësisë së veçantë është që Qeveria të përcaktojë kushtet, që vetë sektori privat të marrë hapa për të:

- Hartuar themelet teknologjikë të Shoqërisë së Informacionit
- Marrë pjesë aktivisht në procesin e standardizimit.

Në procesin e zhvillimit të Shoqërisë së Informacionit është e nevojshme përfshirja e publikut të gjerë dhe veçanërisht organizatave dhe institucioneve jo qeveritare. Roli i tyre pritet që të ofrojë:

DRAFT

- Paraqitjen e projekteve dhe pjesëmarrjen në diskutimet publike mbi legjislacionin;
- Pjesëmarrjen në takimet me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe private për të zgjidhur çështje të rëndësishme të Shoqërisë së Informacionit;
- Mbështetjen në implementimin e projekteve arsimore dhe shpjegimin e efekteve pozitive dhe risqeve lidhur me aplikimin e TIK, sidomos për fëmijët;
- Rritjen e pjesëmarrjes në monitorimin e rezultateve të Strategjisë.

Strategjia do të monitorohet nga Grupi Ndërinstitucional i Punës për Hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale "Axhenda Dixhitale e Shqipërisë 2014-2020" , i ngritur me urdhër të Kryeministrit nr. 13, datë 22.01.2014, Ministri përgjegjës për Administratën Publike dhe Inovacionin, Departamenti i Axhendës Dixhitale pranë Këshillit të Ministrave, Agjencia Kombëtar për Shoqërinë e Informacionit si dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave.

Parakushtet për zbatimin efikas dhe me sukses të "Axhendës Dixhitale 2014-2020 përfshijnë:

- Konsensusin e përgjithshëm për të zbatuar objektivat dhe aktivitet e propozuara;
- Zbatimin në faza të aktiviteteve të përzgjedhura sipas prioriteteve dhe pasja në dispozion të burimeve të duhura;
- Promovimi i objektivave si ndaj sektorit publik dhe privat si dhe ndaj qytetarëve;
- Një sistem i monitorimit dhe vlerësimit efikas për të kontrolluar nëse objektivat e përcaktuara në Strategji janë realizuar. Të dhënat dhe analiza që një sistem monitorimi dhe vlerësimi i tillë do të prodhojë, do të ndihmojnë vendimmarrësit për të rinovuar politikat e tyre, shpërndarjen e burimeve, si dhe të rregullojnë aktivitetet e planifikuara me rrethanat aktuale në çdo kohë të dhënë;
- Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve shtetërore, komunat, OJF-të, organizatat ndërkombëtare dhe pjesëmarrësit e tjerë në proces.

Zbatimi i strategjisë do të bazohet në përdorimin e një numri treguesish sintetikë të lidhur me inputet, proceset, produktet dhe efektet e planit të veprimit.

DRAFT

Treguesit do të vlerësohen në mënyrë periodike nga institucionet publike sipas ndarjes së punës dhe sferës së tyre të juridiksionit. Treguesit do të mblidhen nga DAETIK dhe AKSHI sipas formatit të përcaktuar në Indikatorët për Matjen e Implementimit të Strategjisë në bashkëpunim me institucionet e ndryshme publike dhe INSTAT.

Bazuar në këto tregues Ministri përkatës do të prodhojë raporte vjetore të ecurisë Strategjisë të cilat do të jetë publike.

Ngritja e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi efektiv do të mbështetet nga aktivitetet studimore, aktivitete të forcimit të kapaciteteve njerëzore dhe strukturore si dhe investim në teknologjinë e informacionit. Informimi i publikut, si dhe monitorimi i zbatimit të strategjisë dhe rezultateve të saj nga organizata të specializuara e të interesuara të shoqërisë civile apo media do të përbëjnë gjithashtu një nga elementet bazë të sistemit të monitorimit dhe llogaridhënies së strategjisë "AXHENDA DIXHITALE E SHQIPËRISË 2014-2020".

DRAFT